



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Mami”

ofruar nga

Universiteti “Fan S . Noli” Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Blerina Duka

Dr. Indrit Bimi

Tetor/2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Mami” ofruar nga “Universiteti “Fan.S .Noli”, Korçë**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Fan.S.Noli" Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë.
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Mami”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr.5353 prot, datë 22.08.2005.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 40, datë 15.03.2022.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2023-2024:18 PAE/ 22 PAK V.a 2024-2025:18 PAE/ 20 PAK
18	Numri i studentëve:	31 Studentë v.a 2022-2023 29 Studentë v.a 2023-2024 30 Studentë v.a 2024-2025
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit është hartuar si një program studimi i ciklit të parë Bachelor në përputhje me sistemin europian të transferimit të krediteve dhe Ligjin për arsimin e lartë.

Bazuar në Ligjin Nr. 8461, datë 25.09.1999, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), si dhe me vendim të Senatit të Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës dhe Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe të Njohjes së Diplomave, u hap programi i studimit "Mami" në këtë universitet. Programi u miratua dhe u hap për vitin akademik 2005-2006, duke u ofruar në sistemin me kohë të plotë dhe me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, kjo në bazë të shkresës Nr. 353 Prot., datë 22.08.2005, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Programi bachelor në "Mami", ofrohet në nivel njësie kryesore dhe përgjegjës për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është vetë fakulteti ndërsa njësitë bazë dhe strukturat e tjera japin kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ në funksion të programit të studimit. Aktualisht, programi i studimit Bachelor në Mami zhvillohet me një kohëzgjatje prej 3 vitesh dhe përmban 180 Kredite.

Metodat e mësimdhënies janë të ndërtuara në bazë të parimeve moderne, duke nxitur aplikimin në praktikë të njohurive. Gjithashtu, aktivizimi i studentëve në praktika luan një rol madhor në thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale.

Megjithatë, bashkëpunimet me institucionet shëndetësore do të krijonte më shumë mundësi për praktika profesionale dhe integrimin e studentëve në situata reale.

Programi i studimit Bachelor "Mami", në Universitetin "Fan S.Noli", Korçë i përgjigjet standardeve të vendosura në arsimin e lartë. (Shtojca 2.5.1,2.5.2, 2.5.3 Rregullore e programit të studimit mami 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025 pdf).

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë përbëhet nga 4 fakultete:

1- Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

- Departamenti i Edukimit
- Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja
- Departamenti i Histori dhe Gjeografisë

2- Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane

- Departamenti Biologji-Kimisë
- Departamenti i Infermierisë
- Departamenti i Informatikës
- Departamenti i Matematikës dhe Fizikës
- Departamenti i Shkencave Sociale

3- Fakulteti i Ekonomisë

- Departamenti i Financë-Kontabilitetit
- Departamenti i Marketing-Turizmit
- Departamenti i Menaxhimit

4- Fakulteti i Bujqësisë

- Departamenti i Agrobiznesit

- Departamenti i Agronomisë
- Departamenti i Agroushqimit

(Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO, kreu 2, neni 5).

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të programit të studimit Bachelor “Mami”, i ofruar nga Universiteti “Fan S . Noli” Korçë. Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve për programin e studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive.

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi:

- I.** Ofrimi i programit të studimit;
- II.** Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit;
- III.** Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat;
- IV.** Burimet njerëzore financiare infrastruktura logjistika për realizimin e programit të studimit;
- V.** Studentët dhe mbështetja e tyre;
- VI.** Sigurimi i cilësisë në programin e studimit.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Dr. Blerina Duka dhe Dr. Indrit Bimi.

Koordinator Teknik i ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Alma Arapi. Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.

- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në Universitetin "Fan S . Noli" Korçë është zhvilluar në datat 17.03.2025-18.03.2025. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. Gjithashtu, jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat vlerësohet se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare për gjeneratat e ardhshme të mamive.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Më datë 25.08.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 36/101 Prot., Datë 25.08.2025, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlersimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 1534/3 Prot, Datë 11.09.2025.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft-raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi II.1, Kriteri 1 (Përmbushet Kryesisht):

GVJ: Në lidhje me kriterin *larrin në konkluzionin se Programi i studimit Bachelor në: "Mami"* është në procesin e parë të akreditimit dhe nuk ka kaluar më herët në akreditim, siç pretendohet.

Edhe pse VKM Nr. 823, datë 28.12.2023 është e re, kjo nuk e pengon Njësinë Bazë të hartojë programin sipas udhëzimeve të OBSH dhe standardeve europiane.

Çdo ndryshim në programet lëndore është pasqyrim i kurrikulës së miratuar fillimisht; syllabuset pasojnë dhe bazohen mbi të.

Nuk është e saktë të thuhet se modulet dhe lëndët janë të grupuara sipas kërkesave ligjore; mungon evidenca konkrete.

GVJ: Në lidhje me kriterin 3 **Struktura e kurrikulës dhe modulat e përfshira**. Kurrikula duhet të pasqyrojë standardet ndërkombëtare dhe të jetë e përputhshme me nevojat e tregut dhe kërkesat e lëndëve specifike. Nuk është e qartë si janë ndarë dhe grupuar lëndët sipas kërkesave ligjore. Mungon transparenca për ndarjen e modullave dhe përputhjen me udhëzimet ndërkombëtare.

Gjithashtu në kriterin 4 **Dokumentacioni dhe miratimi i programit**. Programi duhet të ketë një proces të qartë miratimi dhe të dokumentohet çdo ndryshim i mundshëm që ndodh gjatë implementimit të tij. Duhet të pasqyrohen dokumente që vërtetojnë miratimin dhe procesin e zhvillimit të programit, si dhe çdo përmirësim të mundshëm gjatë implementimit.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi II.2, Kriteri 1 (Përmbushet Pjesërisht):

GVJ: Përputhshmëria e njësisë kryesore me programin e studimit.Njësia kryesore e programit duhet të jetë e përputhshme me fushën e studimit dhe të sigurojë menaxhimin e duhur të programit. Njësia e përzgjedhur është jashtë përputhshmërisë me profilin e programit "Mami". Duhet të rishikohet dhe të justifikohet angazhimi i njësisë kryesore në këtë program.

3. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi II.4, Kriteri 1 (Përbushet Pjesërisht):**

GVJ: Ekzistenca e mekanizmave të brendshëm të vlerësimit dhe monitorimit Mungojnë evidencat për funksionimin e mekanizmave të brendshëm të vlerësimit të programit. Nuk janë paraqitur raporte vjetore apo analiza të vazhdueshme të cilësisë. **Përfshirja e palëve të interesuara (studentë, staf, tregu i punës)** Nuk ka prova që tregojnë përfshirjen aktive të studentëve, stafit ose përfaqësuesve të tregut të punës në proceset e rishikimit të programit. Përmendja e bordit këshillimor nuk mbështetet me dokumentacion që vërteton ndikimin e tij në përmirësimin e programit.

4. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi II.5, Kriteri 1 (Përbushet Pjesërisht):**

GVJ: Përfshirja e punëdhënësve dhe institucioneve partnere në zhvillimin e programit

Mungojnë marrëveshjet konkrete me institucione publike ose private që lidhen me fushën e programit "Mami". Nuk ka evidenca që tregojnë bashkëpunim për përmirësimin e përmbytjes mësimore apo organizimin e praktikave. **Sigurimi i praktikave të dobishme dhe reale për studentët.** Praktikrat nuk janë të organizuara në mënyrë të qartë dhe nuk përbajnë planifikim konkret për bashkëpunimin me palët e jashtme. Mungon vlerësimi i ndikimit të këtyre praktikave në përgatitjen profesionale të studentëve.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

5. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi IV.1, Kriteri 7 (Përbushet plotësisht):**

GVJ: Organizimi i praktikave profesionale dhe ndarja e studentëve. Praktikrat profesionale duhet të jenë të organizuara në mënyrë efikase dhe studentët duhet të ndahen në grupe të përshtatshme për të siguruar mbikëqyrje të mjaftueshme. Mungon informacion për ndarjen e studentëve në grupe praktike dhe angazhimin e stafit për mbikëqyrjen e këtyre grupeve. **Planifikimi dhe logjistika e praktikave profesionale.** Programi duhet të ketë një plan të qartë dhe të dokumentuar për organizimin e praktikave, përfshirë oraret dhe përgjegjësitë e caktuara për çdo grup. Nuk ka një plan të detajuar dhe të dokumentuar për praktikrat profesionale, duke lënë në dyshim aftësinë për t'i menaxhuar ato në mënyrë efikase.

**GVJ: Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II – ORGANIZIMI; DREJTIMI
DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR - Përmbushet KRYESISHT**

Standardi IV.I- Është detyrim ligjor zbatimi i VKM nr 41 mbi ndarjen e grupeve mësimore sipas formave mësimore dhe shkencave përkatëse

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Mami”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti "F. S. Noli" Korçë nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Universiteti "Fan.S.Noli", Korçë vepron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. Misioni i tij (Statuti i "Fan S. Noli", neni 3) synon arsimin e lartë gjithëpërfshirës të studentëve vendas e të huaj, studimet dhe kualifikimet e mëtejshme në fushën e mjekësisë dhe ka për qëllim zhvillimin e arsimit, edukimit dhe kërkimit shkencor në fushën e mjekësisë. Ky mision orientohet drejt krijimit, zhvillimit dhe transmetimit të dijeve në aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto për tu bërë ekspert të denjë të fushës së mjekësisë. Evidenca: - <i>Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan S. Noli'.pdf</i> - <i>Shtojca 2.5.1 Rregullore e programit të studimit mami 2022-2023.pdf.pdf</i> - <i>Shtojca 2.5.2 Rregullore e programit të studimit mami 2023-2024.pdf.pdf</i> - <i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit mami 2024-2025.pdf.pdf</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Mami” ofrohet nga Universiteti "F. S. Noli" Korçë. Një nga objektivat kryesorë të "Fan S. Noli" është mësimdhënia, kurrikulat dhe mësimnxënia me në qendër formimin e studentëve (profesionistëve të ardhshëm në mami). Kjo arrihet përmes formimit të specialistëve në fushën e shëndetësisë. Ky program formon profesionistë Mami me formim të përgjithshëm, në përputhje me misionin madhor të Universitetit "Fan S. Noli", që është të rrisë standartet e shëndetit komunitar nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe komunikimit. Universiteti "F. S. Noli" në

	përmbushje të misionit dhe vizionit të tij (neni 2 dhe 3) dhe njëkohësisht aktivitetit të gjithanshëm në fushën e shkencave mjekësore teknike ka organizuar një program studimi i cili plotëson të gjithë spektrin e nevojave që kanë qendrat spitalore si materniteti, qendrat shëndetësore publike e private në vend duke përfshirë në to personel të specializuar në fushën e mamisë. Në përfundim të Programit të Studimit, studentëve iu krijohen këto mundësi: - Vazhdimi i një Programi Studimi të Ciklit të Dytë: Master Profesional në Infermieristikë, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (Viti Akademik 2024-2025). - Vazhdimi i një Programi Studimi të Ciklit të Dytë: Master Profesional në Infermieri pranë një universiteti tjetër, brenda ose jashtë vendit. - Vazhdimi i një Programi Studimi të Ciklit të Dytë: Master Shkencor në Infermieri pranë një universiteti tjetër, brenda ose jashtë vendit. Evidenca: - <i>Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan S. Noli'.pdf</i> - <i>Shtojca 2.5.1 Rregullore e programit të studimit mami 2022-2023.pdf.</i> - <i>Shtojca 2.5.2 Rregullore e programit të studimit mami 2023-2024.pdf.</i> - <i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit mami 2024-2025.pdf.</i> - <i>Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të uniko.pdf.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Strategjia e Universitetit "F. S. Noli" Korçë ka disa objektiva specifike të cilat fokusohen tek organizimi institucional, mësimdhënia, kërkimi shkencor, sigurimi i brendshëm i cilësisë, veprimtaritë shërbyese si dhe marrdhëniet me jashtë/ndërkombëtarizimi. Programi i studimit i ofruar nga "F. S. Noli" është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit. Përmbajtja e programit, është hartuar, përditësuar dhe përshtatur nevojave që ka vendi por njëkohësisht ka reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e mamisë. Programi i studimit Bachelor në "Mami" ofrohet në përputhje me këtë strategji si dhe në përputhje me Rregulloren e Universitetit "F. S. Noli" (Neni 3) dhe Rregulloren e Njësisë Kryesore (Neni 3). Sigurimi i cilësisë

	është një nga pikat kryesore të strategjisë së Institucionit. Evidenca: - <i>Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan S. Noli'.pdf</i> - <i>Shtojca 2.5.1 Rregullore e programit të studimit mami 2022-2023.pdf.</i> - <i>Shtojca 2.5.2 Rregullore e programit të studimit mami 2023-2024.pdf.</i> - <i>Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit mami 2024-2025.pdf.</i> - <i>Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të uniko.pdf.</i> - <i>Shtojca 2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore.pdf.</i> - <i>Shtojca 2.3 Rregullore e njësive bazë departamenti i infermierisë;.pdf.</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti i Korçës është krijuar me vendim nr. 5, datë 07.01.1992 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor (ILB), themeluar në vitin 1971. Ai mban emrin zyrtar "Fan S. Noli", emër që iu dha me vendim të Këshillit të Ministrave në vitin 1994. Universiteti "Fan S. Noli" është një Institucion i Arsimit të Lartë Publik, i akredituar me Vendim Nr. 02, datë 27. 01. 2023. Veprimtaria e Universitetit të Korçës bazohet në nenin 57, pika 7 dhe nenin 58 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL). Përveç kësaj, veprimtaria e tij rregullohet nga akte të tjera ligjore e nënligjore, Statuti i Universitetit, si dhe rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme, të miratuara apo të dalë në zbatim të procesit të Bolonjës. Organet përgjegjëse për hapjen e Programit të Studimit të Ciklit të Parë "Mami" janë Departamenti i Infermierisë, Rektorati i Universitetit "Fan S. Noli" në Korçë, Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli" në Korçë, dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për hapjen e Programit të Studimit të Ciklit të Parë "Mami" është i datës 22.08.2005, me numër vendimi 5353. Ky program ka 180 kredite ETCS dhe kohëzgjatja e tij është 3 vite akademike.

Raporti i stafit akademik në FSHNH për vitin akademik:

- 2022-2023 është 48 PAE, 66 PAK , 3 personel ndihmës, **gjithsej 117**
- 2023-2024 është 49 PAE, 62 PAK , 3 personel ndihmës, **gjithsej 114**
- 2024-2025 është 51 PAE, 66 PAK , 3 personel ndihmës, **gjithsej 120.**

Në total, numri i asistentëve me MSc ka pësuar disa ndryshime, por mbetet një kategori e rëndësishme e stafit akademik. Në vitin akademik 2024-2025, vërehet një rritje e asistentëve me Msc në proces doktorature, ndërsa numri i asistentëve të zakonshëm me MSc ka rënë krahasuar me vitet e mëparshme.

Në përgjithësi, struktura e stafit mbetet relativisht e qëndrueshme.

Universiteti "Fan S. Noli" siguron infrastrukturë të mjaftueshme në programet e studimit që ofron. Laboratorët e Departamentit janë të disponueshëm për realizimin e këtij programi studimi, por nevojitet përmirësim i tyre.

Evidenca:

- *Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan S. Noli' Neni 3 dhe 5 .pdf*
- *Shtojca 2.5.1 Rregullore e programit të studimit mami 2022-2023 pika 6 pdf.*
- *Shtojca 2.5.2 Rregullore e programit të studimit mami 2023-2024 pika 6 pdf.*
- *Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit mami 2024-2025 pika 6 pdf.*
- *Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të uniko.pdf.*
- *Shtojca 2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore.pdf.*
- *Vizita në ambientet e Universitetit "Fan S. Noli" në Korçë.*
- *Shtojca 2.15; Shkresa për hapjen e FSHNH*
- *Shtojca 2.1.1; Çertifikatë dhe vendim akreditimi institucional i UK*
- *Shtojca 2.1; Dokumentacioni i licencimit të programit të studimit*
- *Shtojca 4.6; Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike*
- *Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*

Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Bachelor në “Mami” ofrohet nga Departamenti Infermierisë në FSHNH të UNIKO .Studimet në këtë program synojnë të sigurojnë njohuritë e nevojshme që kanë të diplomuarit në fushën e mamisë, pasi përmbajtja e programit i pajis studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si dhe përgatitje për kërkim shkencor të pavarur për vijimin e mëtejshëm të kualifikimeve dhe studimeve në kujdesin obsetrikal dhe gjinekologjik. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSHNH. Institucioni zbaton me përpikmëri çdo udhëzim apo akt nënligjor të publikuar dhe ka kryer edhe kodifikimin e programit në përputhje me udhëzimin që lidhet me këtë direktivë. Kodi i programit Bachelor në “Mami” është 63BA09138. Evidenca: - Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit “Mami” 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit “Mami” 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit “Mami” 2024-2025 - Shtojca 3.7; Raporti Vjetor i NJSBC FSHNH - Shtojca 2.5.5 Kodi i programit mami.pdf.			
Konkluzione	Pjesa më e madhe e personelit janë me tituj dhe grada. Programi i studimit i ofruar nga "F. S. Noli" është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit. Kriteri 5 duhet të rishikohet sepse nuk është në fushën akademike të njësisë kryesore, duke rekomanduar togfjalëshin “Shkencave të shëndetit ose mjeksore”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione,

kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UNIKO, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e tij, përcakton qartë strukturën e njësive akademike dhe administrative. Çdo njësi ka të sanksionuara funksionet, detyrat dhe rolin e saj në kuadër të organizimit institucional. Evidencat: - Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - Shtojca 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë"; - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 1.19; Rregullore e Këshillit të Etikës UK - Shtojca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional - Shtojca 2.10 Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf. - Shtojca 2.10.1 Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Me qëllim formimin e studentëve dhe për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit mësimor, UNIKO ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda vendit, institucione homologe jashtë vendit si dhe institucione spitalore e të kujdesit shëndetsor parësor ku mund të përmendim: Qendra e Kujdesit Paliativ Mary Potter, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Korçë, Spitali Rajonal Korçë, dhe Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Korçë. Këto marrëveshje ofrojnë mundësi për realizimin e praktikave klinike për studentët, zhvillimin e temave të diplomave, mobilitetin e stafit dhe studentëve, si dhe mundësi për trajnime profesionale dhe pjesëmarrje në projekte të përbashkëta, duke përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në fushën e shëndetësisë. Shikohet e mendimit të ketë marrëdhënie me institucione jashtë vendit në fushën akademike të Mami-së

	Evidenca: - Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB - Shtojca 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022. - Shtojca 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023. - Shtojca 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024. - Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022 - Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023 - Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024 - Shtojca 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale. - Shtojca 3.5 Mobilitete kombetare & nderkombetare te stafit akademik (erasmus+).pdf. - Shtojca 2.10.2 Listë përmbledhese e marrëveshjeve institucionale.pdf. - Shtojca 2.10.1 Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf. - Shtojca 2.10 Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Programi "Bachelor në "Mami" praktikat profesionale sipas evidencave bëhen në spitalin Rajonal të Korçës dhe nuk evidentohet në institute kërkimore. GVJ gjykon që është e mjaftueshme realizimi i praktikave pranë këtij spitali, duke pasur dhe eksperiencën disavjecare. Evidenca: - Shtojca 2.10.2 Listë përmbledhese e marrëveshjeve institucionale.pdf. - Shtojca 2.10.1 Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf. - Shtojca 2.10 Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf - Shtojca 3.16.2 Udhëzues vlerësimi i praktikave mësimore, klinike-profesionale.

	- Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB - Shtojca 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022. - Shtojca 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023. - Shtojca 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024. - Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022 - Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023 - Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Universiteti ka nënshkruar marrëveshje dhe bashkëpunime që synojnë të kontribuojnë në përgatitjen sa më të mirë të studentëve për sfidat profesionale Megjithatë, nuk janë hartuar raporte periodike dhe analiza mbi përfitimet e këtyre marrëveshjeve, dhe nuk ka evidencë të dokumentuar që të pasqyrojë ndikimin e tyre, çka është thelbësore për përcaktimin e strategjive që synojnë rritjen e cilësisë akademike dhe profesionale. Zhvillimi i bashkëpunimeve të reja, është pjesë e strategjisë së zhvillimit të UNIKO, proces i cili kryhet dhe zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme. GVJ rekomandon që të plotësohet kënaqshëm duhet të hartohen raporte periodike për të realizuar një analizë SWOT të secilës marrëveshje në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Evidenca: - Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të uniko.pdf. - Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022 - Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023 - Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024

Konkluzione	Për përmbushjen e kërkesave të kriterit 2, është e nevojshme vendosja e marrëdhënieve të qëndrueshme me institucione të huaja në fushën akademike të Mamisë. GVJ rekomandon që, për të garantuar përmbushjen e kënaqshme dmth plotësisht të këtij kriteri, të hartohen raporte periodike vlerësimi, të cilat të përfshijnë analiza të detajuara SWOT për çdo marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	%Programi i Studimit të Ciklit të Parë "Mami" është miratuar me vendim nr. 5353, datë 22.08.2005. Ky program studimi ofrohet me një total prej 180 krediteve (ECTS) dhe ka një kohëzgjatje prej tre vitesh akademike. Në fund të këtij programi, studentët marrin diplomën "Bachelor" në fushën e studimit përkatës. Programi është i ndarë në module dhe është i vlerësuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Çdo semestër ka 15 javë mësimore, duke përfunduar me gjithsej 90 javë mësimore për të gjithë programin. Çdo semestër është i vlerësuar me 30 kredite, ndërsa çdo vit akademik ka 60 kredite, duke arritur një total prej 180 kreditesh, në përputhje me Ligjin 80/15 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Nenet 70 dhe 73. Programi është i organizuar në module dhe lëndët janë të kategorizuara sipas veprimtarisë formuese, duke u ndarë në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Shpërndarja e krediteve është si më poshtë:

	- A- Lëndë bazë: 32 ECTS (18.8%) - B- Lëndë karakterizuese: 99 ECTS (55%) - C- Lëndë ndërdisiplinore/integruese: 23 ECTS (12.8%) - D- Lëndë plotësuese: 19 ECTS (10.6%) - E- Detyrime përmbyllëse dhe diploma: 7 ECTS (3.9%) GVJ evidenton që plani mësimor të përafrohet në të ardhmen deri në vitin 2027, me VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023: PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR. Evidenca: - <i>Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB</i> - <i>Shtojca 2.1 Dokumentacioni i licencimit të programit të studimit M (2).pdf.</i> - <i>Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025</i> - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara	Në total, programi i studimit përmban 48 lëndë duke u ndarë në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese me 173 kredite në total dhe 7 kredite të provimit të diplomës. GVJ rekomandon që ky program duhet të ketë përqindje më të madhe të lëndëve të fushës së kujdesit të nënës dhe fëmijës.

në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

Profili i Lëndëve të Programit të Studimit	Orë mësimore	Përqindja e orëve	Kredite	Përqindja e krediteve
Mami	718	32.6 %	57	31.6 %
Infemieror	450	20.1 %	34	18.9 %
Mjekësor	784	35.6 %	63	35.0 %
Shkencor	219	10 %	16	8.9 %
Gjuhë e Huaj (Anglisht.)	38	1.7 %	3	1.7 %
Provim Formimi / Punimi i Diplomës	—	—	7	3.9 %
Totali	2209	100 %	180	100 %

Nisur nga analiza e tabelës së lëndëve të programit të studimit, vërehet se është e nevojshme të rishikohet struktura e kurrikulës me qëllim që të rritet përqindja e lëndëve që lidhen drejtpërdrejt me fushën e Mamisë.

Evidenca:

- Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023
- Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024
- Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025
- Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023
- Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024
- Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025
- Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB
- Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).
- Shtojca 2.8.1; Model programi lëndor

Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Nga plani mësimor lëndët janë ndarë në:

- **A- Lëndë bazë (32 ECTS - 18.8%):** Ofron njohuri thelbësore për fushën.
- **B- Lëndë karakterizuese (99 ECTS - 55%):** Fokusohet në aftësi specifike dhe avancuara.
- **C- Lëndë ndërdisiplinore (23 ECTS - 12.8%):** Ndhmon në integrimin e njohurive nga fusha të ndryshme.
- **D- Lëndë plotësuese (19 ECTS - 10.6%):** Zgjeron njohuritë dhe aftësitë në fusha të tjera.
- **E- Detyrime përmbyllëse dhe diploma (7 ECTS - 3.9%):** Përmbyll programin dhe vlerëson njohuritë dhe aftësitë.

	Ky është një program studimi me 180 kredite (ECTS), nuk ka të përfshira module brenda lëndëve dhe është i vlerësuar) në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). GVJ rekomandon që të grupohen lëndët dhe modulet sipas VKM nr 41. Evidenca: - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB - Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset). - Shtojca 2.8.1; Model programi lëndor
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e një programi studimi sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. datë 24.01.2018 të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore. GVJ rekomandon që ky plan mësimor nevojitet të ndryshohet dhe përshtatet me VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023: PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR. Evidenca: - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025

	- Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB - Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset). - Shtojca 2.8.1; Model programi lëndor - Shtojca 2.18.3 Manuali i hartimit të temës së diplomës
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	NA
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Për kriterin 6, GVJ nuk evidentoi një evidencë të tillë gjatë takimeve me stafet e UNIKO-së, dhe evidencave të paraqitura. pra nuk disponohet ndonjë evidencë që të tregojë se është kryer një krahasim ndërmjet programeve ekzistuese në të njëjtën fushë, cikël dhe emërtim, për të vlerësuar nëse ato përputhen në nivelin minimal të kërkuar prej 70% në përmbajtje dhe objektiva mësimore, sipas standardeve të përcaktuara Evidenca: - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - -Takim me stafin e UNIKO.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra	Universiteti i Korçës (UNIKO) ka realizuar një ndarje të strukturuar të programeve të studimit, duke përdorur kode specifike për secilin program. Programi i studimit Bachelor në "Mami" është kodifikuar sipas kriterëve përkatës dhe fushës së studimit, me kodin 63BA09L38.

publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Evidenca: - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - Shtojca 4.12; Praktika e plotë e dokumentacionit "për kodifikimin e lëndëve të programit të studimit"			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA			
Konkluzione	GVJ evidenton që plani mësimor të përafrohet në të ardhmen deri në vitin 2027, me <i>VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023: PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR.</i> GVJ rekomandon që ky program duhet të ketë përqindje më të madhe të lëndëve të fushës së kujdesit të nënës dhe fëmijës. GVJ rekomandon që të grupohen lëndët dhe modulet. Nuk e përcakton VKM			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush	Kriteri 1 duhet të përmirësohet sepse nuk është në fushën akademike të njësisë kryesore, duke rekomanduar togfjalëshin "Shkencave të shëndetit ose mjekësore". Ndërsa njësia bazë përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane për vitet akademike 2023-2024 dhe 2024-2025 ka në përbërjen e tij: akademike

FSHNSHH	2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	2	6	2	6
Prof.As.Dr	2	5	2	5
Dr	26	6	27	7
MSC	13	45	20	48
Total	49	62	51	66

Departamenti i Infermierisë	2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr		1		1
Prof.As.Dr				
Dr	4	1	5	2
MSc	7	19	7	17
Total	11	21	12	20

Evidenca:

-
- *Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë*
- *Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*
- *Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023*
- *Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024*
- *Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025*
- *Shtojca 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë";*
- *Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e

GVJ rekomandon punësimin e së paku një laboranti në fushën përkatëse në mënyrë që të përmbushet kriteri 2.
Stafi mbikqyrës i praktikës profesionale i raportuar nga Institucioni, bazuar dhe në Statutin e UK, janë staf i spitaleve dhe kjo është një pikë

studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	e fortë për këtë program studimi, por nuk ka laborant të angazhuar në program, dhe sipas profilit e studimit. Evidenca: - <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO.pdf.</i> - <i>Shtojca 3.16.1 Udhëzues & rregullore e praktikave mësimore, klinike-profesionale.pdf</i> - <i>Shtojca 3.16.2 Udhëzues vlerësimi e praktikave mësimore, klinike-profesionale.pdf</i> - <i>Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB</i> - <i>Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).</i> - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në bazë të Rregullores së organizimit dhe veprimtarisë mësimore kërkimore Kreu II, Neni 14 Koordinatori i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe mbarvajtjen e programit dhe praktikave profesionale. Paralelisht, ai informon drejtuesin e departamentit për problematikat e ndryshme. Koordinatori propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohet nga Dekani. Kjo procedurë u konfirmua dhe në takimin me Drejtuesit e Njësive kryesore/Bazë. GVJ në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstaton që institucioni tregon një angazhim serioz për mbikëqyrjen e realizimit të praktikës klinike, duke siguruar që studentët të marrin mbështetje të plotë dhe udhëzime profesionale gjatë gjithë periudhës së praktikës. Koordinator i programit nuk është i profesionit Mami, por infermier i përgjithshëm. GVJ rekomandon që kordinatori i programit të jetë me një nga ciklet e diplomimit Mami. Evidenca: - <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO.pdf.</i> - <i>2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore.pdf.pdf</i> - <i>Shtojca 2.11; Vendimi i njësisë bazë për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimit.</i> - <i>Shtojca 4.13; Vendimi rektoratit "Grupi monitorimit procesit mësimor"</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me studentët</i>
Konkluzione	<i>Kriteri duhet të përmirësohet sepse nuk është në fushën akademike të</i>

	<i>njësisë kryesore, duke rekomanduar togfjalëshin "Shkencave të shëndetit ose mjeksore". Ndërsa njësia bazë përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</i> <i>GVJ rekomandon punësimin e së paku një laboranti në fushën përkatëse në mënyrë që të përmbushet plotësisht kriteri 2.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij programi studimi është i disponueshëm pranë Njesisë Kryesore. Statuti dhe Rregullorja e Institucionit përcaktojnë rregullat e përgjithshme, ndërsa informacionet më të detajuara për këtë program studimi paraqiten në Rregulloren e Njesisë Kryesore, Njesisë Bazë dhe në Rregulloren e programit të studimit. Evidenca: - Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO.pdf. - Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 2.14; Struktura dhe organigrama e UK - Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022 - Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023 - Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe

	<i>kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025</i> - <i>Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Ky është një program studimi me 180 kredite (ECTS). Programi i formimit për mamitë përbëhet nga të paktën 4500 orë formimi teorik dhe praktik me të paktën 1/3 e kohëzgjatjes minimale që përfaqëson formimin klinik . GVJ evidenton që ka predispozitë nga ana e stafëve që të shtojnë orët e praktikave, por VKM nr 41 i ka kufizuar për shkak të nenit 2.1. të VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË. Evidenca: - <i>Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025</i> - <i>Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset)</i> - <i>Shtojca 3.14; Udhërrëfyesi i studentëve (prezantimi me vitet e para)</i> - <i>Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Neni 55 i Statutit të Institucionit përcakton se në programet e studimit të ciklit të parë pranohen si studentë vendas ashtu edhe të huaj, ndërsa detajet e pranimit janë të përfshira në rregulloren e programit të studimit (Neni 46). Transferimi dhe ekuivalentimi i studimeve, diplomave dhe kalimi nga një program në një tjetër rregullohen nga Neni 60 i rregullores së Institucionit UK, Neni 66 i Statutit dhe pika 15 e Rregullores së programit të studimit. Po ashtu, pika 7 e Rregullores së rogramit të studimit përcakton politikat e pranimit në programin e studimeve.

	Evidenca: - Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset) - Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB - Shtojca 3.19; "Propozim për kuotat & kriteret e pranimit të studentëve".
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Sipas nenit 71 të Rregullores së Universitetit F. S. Noli Korçë , stafi akademik është i detyruar të hartojë programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe ta dorëzojë atë në Departament. Programi lëndor (syllabusi) përmban: titullarin ose pedagogun e lëndës, ngarkesën, tipologjinë e lëndës, vitin akademik ose semestrin kur zhvillohet, llojin e lëndës, programin e studimit, kodin e lëndës dhe adresën elektronike të titullarit ose pedagogut të lëndës. Ai gjithashtu përfshin një përmbledhje dhe rezultatet e të nxëniet, konceptet themelore, temat e lëndës, formën e kontrollit të dijeve, frekuentimin, kontrollin e vazhdueshëm si dhe literaturën, e cila ndahet në literaturë bazë të detyrueshme dhe literaturë të rekomanduar. Në fund, përfshihen edhe vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës. GVJ evidenton që syllabuset duhen përmirësuar. Evidenca: - Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit

	2024-2025 - <i>Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset)</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Në takimin me stafin akademik ata raportuan se çdo fillim viti dorëzojnë syllabuset me ndryshimet/përmirësimet përkatëse. GVJ evidenton që nuk ka një procedurë të përmirësimit të syllabuseve dhe rekomandon që të përfshihet NJSBC në këtë proces, ose të ndahet DI në grupe mesimore/shkencore. Nuk ekziston asnjë evidencë zyrtare që të dokumentojë qartë përmirësimin apo përditësimin e syllabuseve, as ndonjë dosje që të pasqyrojë hap pas hapi këtë proces. Evidenca: - <i>Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - <i>Shtojca 2.12.1; Praktika e plotë për miratimin e ndryshimeve të propozuara në kurrikulën e programit</i> - <i>Shtojca 2.12.2; Procedura e ndryshimeve në planin mësimor (rishikimi i kurrikulës).</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>			
Konkluzione	GVJ gjatë vlerësimit të programit është evidentuar një predispozitë pozitive nga ana e stafit akademik për të shtuar orët e praktikës klinike, në përputhje me nevojat e formimit profesional të studentëve. Megjithatë, kjo dëshirë has në kufizime të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi, konkretisht nga neni 2.1 i VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 41, DATË 24.1.2018, 'PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË', i cili përcakton kufij të qartë mbi shpërndarjen e krediteve dhe të ngarkesës mësimore në komponentët teorikë dhe praktikë. Për rrjedhojë, çdo rishikim i strukturës së programit duhet të realizohet brenda këtyre kufijve ligjorë, duke balancuar nevojën për praktikë me respektimin e dispozitave në fuqi. GVJ evidenton që syllabuset duhen përmirësuar dhe nuk ka një procedurë të përmirësimit të syllabust dhe rekomandon që të përfshihet NJSBC në këtë proces, ose të ndahet DI në grupe mesimore/shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ evidenton që programi mësimor në të ardhmen duhet të përafrohet me “ VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023: PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR” . Por dhe me kurrikula në rajon dhe direktivat europiane. https://www.zf.uni-lj.si/images/ANG/BA_-_predmetnik_20-21_jan.pdf https://projects.tuni.fi/app/uploads/2020/12/2a61af88-introduction-ljubljana-university.pdf Evidenca: - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset) - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit “Mami” 2022-2023 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit “Mami” 2024-2025
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	GVJ duke u nisur nga lëndët e zhvilluara gjatë tre viteve akademike konstaton që programi i studimit i afrohet më shumë strukturës dhe përmbajtjes së programit "Infermier i Përgjithshëm", se sa programit të profilit Mami. VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023: PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR” .

	https://www.zf.uni-lj.si/images/ANG/BA_-_predmetnik_20-21_jan.pdf https://projects.tuni.fi/app/uploads/2020/12/2a61af88-introduction-ljubljana-university.pdf Evidenca: - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - Shtojca 4.15; VKM 41/2018 (e ndryshuar) - Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ duke u nisur nga lëndët e zhvilluara gjatë tre viteve akademike konstaton që programi i studimit i afrohet më shumë strukturës dhe përmbajtjes së programit "Infermier i Përgjithshëm", se sa programit të profilit Mami. VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023: PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR". https://www.zf.uni-lj.si/images/ANG/BA_-_predmetnik_20-21_jan.pdf https://projects.tuni.fi/app/uploads/2020/12/2a61af88-introduction-ljubljana-university.pdf GVJ konsideron se orët e praktikës profesionale janë në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi, por për vitet e ardhshme në zbatim të VKM nr.41/2018, ndryshuar së fundmi me VKM nr.823/2023, këto orë do të rriten për programin e Bachelor në Mami, në të gjitha IAL në nivel vendi (brenda vitit 2027). (këtu e pranon që VKM zbatohet në vazhdim)

	Evidenca: - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022 - Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023 - Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024 - Shtojca 2.17.1; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik 2021-2022. - Shtojca 2.17.2; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë ,per vitin akademik 2022-2023.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ evidenton që nuk mund të arrijnë të bëjnë mobilitet me BE dhe as me Universitetet Shqiptare sepse ska një evidencë të tillë. Analiza e strukturës dhe përmbajtjes së programit tregon se ai i përafrohet më shumë një programi të profilit 'Infermier i Përgjithshëm', sesa një programi tipik të profilit 'Mami'. Në përfundim të studimeve, punësimi i studentëve është i mundur. Nga takimi me studentët dhe stafin akademik u evidentua se një pjesë e vetë stafit akademik shërben si treg pune, duke punësuar ish studentët e tyre apo i kanë referuar tek kolegët e tyre për punësim në klinikat private. https://www.zf.uni-lj.si/images/ANG/BA_-_predmetnik_20-21_jan.pdf https://projects.tuni.fi/app/uploads/2020/12/2a61af88/

	introduction-ljubljana-university.pdf Evidenca: - <i>Shtojca 2.4.1 Raporti i analizes vjetore të veprimtarisë mësimore, kerkimore dhe financiare i uk 2021-2022.pdf</i> - <i>Shtojca 2.4.2 Raporti i analizes vjetore të veprimtarisë mësimore, kerkimore dhe financiare i uk 2022-2023.pdf</i> - <i>Shtojca 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kerkimore dhe financiare i uk 2023-2024.pdf.</i> - <i>Shtojca 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë";</i> - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025</i> - <i>Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - <i>Shtojca 3.5 Mobilitete kombetare & nderkombetare te stafit akademik (erasmus+).pdf.</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ evidenton që nuk ka një procedurë të përmirësimit të syllabust dhe rekomandon që të përfshihet NJSBC në këtë proces, ose të ndahet DI në grupe mesimore/shkencore. Megjithëse syllabuset përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm, ato kërkojnë rishikim dhe përmirësim në përputhje me dispozitat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, që përcakton standardet për hartimin dhe strukturën e tyre. Evidenca: - <i>Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).</i> - <i>Shtojca 2.8.1; Model programi lëndor</i> - <i>Shtojca 3.12 Raport informues i bibliotekës shkencore të uk mbi botimet dhe përditësimet e literaturës.pdf.</i> - <i>Shtojca 3.12.1 Biblioteka online j-store + u-library.pdf</i> - <i>Shtojca 3.13 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës</i>

	<i>fshnh.pdf.pdf</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ evidenton që programi i përmbahet pjesërisht kompetencave të Mami-së sepse VKM nr 823 dhe direktivat europiane e kanë të përshkruar ndryshe. Analiza tregon se programi aktual përmban vetëm pjesërisht kompetencat e përcaktuara nga VKM nr. 823, datë 28.12.2023 dhe Direktivës 2005/36/KE të BE-së, të cilat përfshijnë menaxhimin e kujdesit në para lindje, asistencën në lindje dhe pas lindjes, reagimin në emergjencë dhe zbatimin e praktikave profesionale dhe etike. Për këtë arsye, rekomandohet rishikimi dhe përmirësimi i programit për të siguruar përputhshmërinë e plotë me standardet ligjore dhe evropiane, duke integruar të gjitha kompetencat profesionale në planin mësimor dhe syllabuset. Evidenca: - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ nuk evidenton një studim tregu për programin "Mami". Ekziston një mungesë e studimeve të thelluara të tregut të punës në lidhje me nivelin e punësimit të studentëve në profesionin për të cilin janë diplomuar konkretisht për programin Mami. Aktualisht, janë të disponueshme vetëm të dhëna që lidhen me kalueshmërinë në provimin praktik dhe në provimin e shtetit, si dhe me pajisjen me leje ushtrimi profesioni, të siguruar nga Urdhri i Infermierit. Evidenca: - <i>Shtojca 2.16; Gjurmimi i ecursisë së punësimit (alumni) dhe UISH</i> - <i>Shtojca 3.11 Studim tregu për programin e studimit</i> - <i>Shtojca 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA</i> - <i>Shtojca 4.8; Webfaqja e UK</i> - <i>Shtojca 4.9; Webfaqja e FSHNH</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Konkluzione	GVJ evidenton që programi mësimor duhet të përafrohet në të ardhmen, deri në vitin 2027 me " VENDIM Nr. 823, datë

	28.12.2023: PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR". Por dhe me kurrikula në rajon dhe direktivat europiane. https://www.zf.uni-lj.si/images/ANG/BA - predmetnik_20-21_jan.pdf https://projects.tuni.fi/app/uploads/2020/12/2a61af88-introduction-ljubljana-university.pdf GVJ vëren se programi i studimit "Mami" në strukturën dhe përmbajtjen e tij i përafrohet më shumë programit "Infermier i Përgjithshëm". Gjithashtu, nuk është evidentuar një studim tregu që të mbështesë ofrimin e këtij programi në përputhje me nevojat reale të tregut të punës. GVJ konstaton se mungon mundësia e mobilitetit të studentëve dhe stafit, si me vendet e Bashkimit Europian ashtu edhe me universitetet e tjera shqiptare. Përmirësimin e syllabus-it. GVJ rekomandon që ky proces të përfshijë Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ose, alternativisht, të organizohet Departamenti në njësi të ndara mësimore apo shkencore, me qëllim forcimin e përgjegjësiave për garantimin e cilësisë akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecures së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e	Për kriterin 1, GVJ evidenton që nuk ka evidencë të tillë që është përshtatur apo riorganizuar. Aktualisht nuk ka evidenca të qarta që tregojnë se programi është përshtatur apo riorganizuar në mënyrë sistematike në përputhje me kërkesat e tregut të punës Evidenca: - Shtojca 3.11; Studim tregu për programin e studimit - Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik;

institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	- <i>Takim me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Në përputhje me parashikimet ligjore dhe Statutin e UK, Senati Akademik përfshin në përbërjen e tij edhe studentë. Institucioni ka ngritur gjithashtu Këshillin Studentor, duke garantuar përfaqësimin e studentëve në komisione të ndryshme, përfshirë proceset e akreditimit. Një tjetër mekanizëm efektiv është senatori i klasës, i cili ka shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe strukturave drejtuese, duke funksionuar në mënyrë optimale. Këto u konfirmuan edhe në takimin me studentët, të cilët raportuan se kanë akses të hapur në Drejtuesinë e Njesisë Kryesore për adresimin e problematikave të ndryshme. Gjithashtu, studentët raportuan për përfshirjen e tyre aktive, duke dhënë mendimin për organizimin e konferencave dhe duke marrë pjesë në vendimmarrje institucionale. Vlerësimi i stafit akademik nga ana e studentëve rezulton pozitiv. Evidenca: - <i>Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - <i>Shtojca 1.17; Rregullorja e Këshillit Studentor</i> - <i>Shtojca 3.11; Studim tregu për programin e studimit</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Ka marrëveshje me aktorë të ndryshëm, por nuk disponohen raporte analitike dhe të vazhdueshme lidhur me ecurinë e programit për çdo vit akademik, çka përbën një mangësi në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të programeve. GVJ vlerëson si të rëndësishme rritjen e vazhdueshme të këtij bashkëpunimi për të përmirësuar dhe përditësuar programet akademike. Evidenca: - <i>Shtojca 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.</i> - <i>Shtojca 2.16 Gjurmimi i ecurisë së punësimit (Alumni) dhe UISH (Urdhëri i Infermierit të Shqipërisë) .pdf.</i> - <i>Shtojca 2.10.1; Marrëveshje bashkëpunimi të FSHNH</i> - <i>Shtojca 2.10.2; Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale;</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik.</i>
Konkluzione	<i>Për kriterin 1, nuk ka evidencë të qarta që tregojnë se</i>

	<i>programi është përshtatur apo riorganizuar në mënyrë sistematike në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Janë të disponueshme vetëm të dhëna mbi kalueshmërinë në provimin praktik dhe provimin e shtetit, si dhe mbi pajisjen me lejen e ushtrimit të profesionit, të siguruar nga Urdhri i Infermierit , por dhe keto jo te perditësuar në vitet e fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Sipas Rregullores së Institucionit, Rregullores së Njësisë Kryesore dhe Rregullores së programit të studimit, përcakton format e mësimdhënies. Ato janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, laboratorët etj. Programi i studimit është i strukturuar duke përfshirë një gamë të gjerë metodash mësimdhënieje, si leksione, seminare, laboratorë, praktika profesionale dhe klinike, përgatitjen e detyrave të kursit, tema diplome, punë kërkimore në laborator, si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. Institucioni inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve në konferenca, trajnime dhe workshope, duke nxitur zhvillimin akademik dhe profesional të tyre. Evidenca: - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset). - Takim me stafin akademik;

	- <i>Takim me studentët;</i> - <i>Takim me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Sipas stafeve personeli akademik përdor një gamë të gjerë metodash alternative të mësimdhënies për të siguruar zhvillimin e procesit mësimor në mënyrë sa më të përshtatshme për studentët. Metodat e përdorura përfshijnë PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike dhe teknika të tjera, të cilat synojnë ta bëjnë mësimin më interesant dhe interaktiv. Këto metoda janë të konfirmuara nga studentët, të cilët i kanë vlerësuar ato si efektive në përmirësimin e angazhimit dhe kuptimit të materialeve mësimore. Në kuadër të plotësimit të kriterit 2 GJV rekomandon që këto metoda të pasqyrohen dhe në syllabus si forma mësimore: si psh raste klinike apo forma të tjera apo: 1. Mësimi i Bazuar në Projekte (Project-Based Learning - PBL) 2. Mësimi i Flipped Classroom (Klasa e Anasjelltë) 3. Mësimi i Bazuar në Simulime dhe Laborator Virtual 4. Gamifikimi në Procesin e Mësimdhënies 5. Mësimi i Asistuar nga Inteligjenca Artificiale 6. Mësimi i Bazuar në Studime Rasti Evidenca: - <i>Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB</i> - <i>Shtojca 4.8; Webfaqja e UK</i> - <i>Shtojca 4.9; Webfaqja e FSHNH</i> - <i>Shtojca 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library</i> - <i>Shtojca 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022.</i> - <i>Shtojca 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023.</i> - <i>Shtojca 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024.</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e	GVJ evidenton se ka trajnime apo manuale të mësimdhënies që ndihmojnë pedagogun dhe studentin në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Për një përmirësim më të qëndrueshëm dhe sistematik të cilësisë së mësimdhënies, GJV rekomandon krijimin e moduleve të brendshme trajnimi, manualeve udhëzuese për pedagogët dhe ndërtimi i një strategjie institucionale për zhvillimin e vazhdueshëm akademik. Evidenca:

prishme të të nxënit.	- Shtojca 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022. - Shtojca 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023. - Shtojca 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024. - Shtojca 1.23; Rregullore e Drejtorisë së Projekteve dhe Kërkimit Shkencor - Shtojca 2.10.3; Lista e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare; - Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022 - Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023 - Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024 - Takim me stafin akademik; - Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Takim me përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin - https://innovativeteachingideas.com/blog/a-teachers-guide-to-blooms-taxonomy/?srsltid=AfmBOoqDLRqwwvZEZU-DG_fvGxd9E85ioEAY9mrbC-UHUbBtF9ijBbYS - https://swu.phinma.edu.ph/wp-content/uploads/2021/05/Nurse-as-Educator-Principles-of-Teaching-and-Learning-for-Nursing-Practice-by-Susan-B.-Bastable-z-lib.org_.pdf
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentet	Gjatë takimeve me autoritetet drejtuese dhe Burimet Njerëzore, u raportua se UK përpiqet të rekrutojë staf me eksperiencë të mjaftueshme në mësimdhënie. Por GVJ evidenton që nuk janë të pasqyruar në syllabus format mesimore si psh raste klinike apo forma të tjera. Evidenca: - Shtojca 2.9; CV Jetëshkrimet e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit. - Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësues të Burimeve Njerëzore.

mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	GVJ evidenton që ka pyetësor për studentët, por rekomandohet që të zhvillohet në nivel programi nje analize e tillë. Pra në nivel programi mungon një analizë e thelluar dhe e strukturuar për efektivitetin e këtyre metodave. Evidenca: - <i>Shtojca 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor</i> - <i>Shtojca 3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët</i> - <i>Shtojca 3.8.3; Shembull vlerësimi të performancës së stafit akademik</i> - <i>Shtojca 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH</i> - <i>Shtojca 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me	GVJ evidenton se mungojnë trajnime të strukturuar dhe udhëzuese që mbështesin pedagogët dhe studentët në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Nuk disponohen evidenca të qarta që të tregojnë organizimin e vazhdueshëm të trajnimeve për stafin akademik apo angazhimin institucional në përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor. Për këtë arsye, GVJ rekomandon hartimin e moduleve të brendshme trajnimi, zhvillimin e manualeve orientuese për pedagogët, si dhe ndërtimin e një strategjie të mirëfilltë institucionale për zhvillimin profesional dhe akademik të stafit. Evidenca:

njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	• <i>Shtojca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrii rregulluakulës dhe Vlerësimit Institucional</i> • <i>Shtojca 3.10; Lista e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC)</i> • <i>Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.</i> • https://www.odu.edu/sites/default/files/documents/teaching-handbook.pdf • <i>The Wiley Handbook of Sustainability in Higher Education Learning and Teaching. Author(s): Kelum A. A. Gamage, Nanda Gunawardhana. Series: Wiley Handbooks in Education. Publisher: Wiley-Blackwell, Year: 2022. ISBN: 111985282X,9781119852827</i> • https://swu.phinma.edu.ph/wp-content/uploads/2021/05/Nurse-as-Educator-Principles-of-Teaching-and-Learning-for-Nursing-Practice-by-Susan-B.-Bastable-z-lib.org_.pdf			
Konkluzione	<i>GVJ rekomandon të pasqyrohen në syllabus format mësimore si psh raste klinike apo forma te tjera apo:</i> 1. <i>Mësimi i Bazuar në Projekte (Project-Based Learning - PBL)</i> 2. <i>Mësimi i Flipped Classroom (Klasa e Anasjelltë)</i> 3. <i>Mësimi i Bazuar në Simulime dhe Laborator Virtual</i> 4. <i>Gamifikimi në Procesin e Mësimdhënies</i> 5. <i>Mësimi i Asistuar nga Inteligjenca Artificiale</i> 6. <i>Mësimi i Bazuar në Studime Rasti</i> <i>GVJ evidenton se nuk ka trajnime apo manuale të mësimdhënies që ndihmojnë pedagogun dhe studentin në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i> <i>Gjithashtu GVJ evidenton që nuk janë të pasqyruar në syllabus format mesimore si psh raste klinike apo forma te tjera.</i> <i>GVJ evidenton që ka pyetësorë për studentët, por rekomandohet që të zhvillohet në nivel programi nje analize e tillë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni ka një bazë ligjore të plotë që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve, të cilat janë të njohura dhe të disponueshme për studentët që në fillim të vitit akademik. Rregullorja e programit të studimit dhe rregulloret e përgjithshme të institucionit përcaktojnë qartë modalitetet e testimit të njohurive. Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen format e kontrollit të njohurive. Për disa vjet, Departamenti i Infermierisë përdor sistemin automatizuar CLEANSORE për korrigjimin e provimeve, i financuar nga AADF. Sipas Nenit 63 të Rregullores së institucionit, Rregullorja e Njesisë Kryesore dhe Rregullorja e Programit të studimit përcaktojnë kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Vlerësimi i studentëve bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është një kombinim i elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 70 % 2. Vlerësimi i vazhduar 30 % - Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive 10% - Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 5 – 10 % - Testimet gjatë vitit 10 – 15 % Evidenca: - Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 2.3; Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Infermierisë"; - Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH

	- <i>Shtojca 2.18; Kontrata AADF me UK</i> - <i>Shtojca 2.18.2; Model testimi clean score</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo moduli, pedagogu informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, informacion që është gjithashtu i dokumentuar në syllabuset përkatëse të lëndëve. Ky informacion është konfirmuar si nga stafi akademik, ashtu edhe nga studentët gjatë takimeve. Procedura e vlerësimit është e qartë dhe transparente, dhe studentët janë të informuar për detyrimet që kanë në përfundim të lëndës/modulit. Evidenca: - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - <i>Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve	Sipas Kreut IV të Rregullores së Njësisë Kryesore dhe sipas pikës 16 të Rregullores së programit të studimit, kontrolli i

dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektsh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. GVJ rekomandon që të përmirësohet infrastruktura laboratorike për të bërë testimin e njohurive praktike. Evidenca: - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Shtojca 2.18; Kontrata AADF me UK</i> - <i>Shtojca 2.18.2; Model testimi clean score</i> - <i>Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Stafi akademik punon vazhdimisht të përmirësojë format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë në këtë proces edhe studentët e programit të studimit sipas një pyetësori në nivel institucional. Evidenca: - <i>Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).</i> - <i>Shtojca 4.8; Webfaqja e UK</i> - <i>Shtojca 4.9; Webfaqja e FSHNH</i> - <i>Shtojca 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor</i> - <i>Shtojca 3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët;</i> - <i>Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje	Autonomia dhe liria akademike është një pikë kryesore të cilën e gëzojnë stafi akademik dhe studentët. Mësimdhënia mundohet të fokusohet tek nevojat e studentëve (raportoi stafi akademik), në bazë të objektivave të programit të studimit dhe të objektivave specifike të lëndës ndërsa studentët raportuan

me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	se kanë lirinë të shprehin mendimet dhe idetë e tyre gjatë leksioneve/seminareve. Në përfundim të secilit modul është parashikuar zhvillimi i provimit përkatës. Evidenca: - Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - 4.6 Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike .pdf.pdf - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.			
Konkluzione	GVJ rekomandon që të përmirësohet infrastruktura laboratorike për të bërë testimin e njohurive praktike. GVJ e konsideron këtë një praktikë të mirë që UNIKO duhet të vazhdojë ta ndjekë por rekomandon që pyetësori të realizohet në nivel programi, duke qënë se dhe njësia kryesore nuk është në profilin e shkencave të shëndetit dhe mjeksore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rregulloren e Programit të studimit raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe në syllabuse raportohet se nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 70 % 2. Vlerësimi i vazhduar 30 % - Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive 10%

	- Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 5 – 10 % - Testimet gjatë vitit 10 – 15 % Të gjitha mënyrat dhe elementet e vlerësimit janë të parashikuara në syllabuse dhe rregullore, të cilat prezantohen edhe nga titullari i lëndës. Evidenca: - <i>Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i> - <i>Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).</i> - <i>Shtojca 4.8; Webfaqja e UK</i> - <i>Shtojca 4.9; Webfaqja e FSHNH</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni prej disa vitesh ka vënë në përdorim platformën e korrigjimit të provimeve Clean Score në bashkëpunim me AADF. Projekti zbatohet prej disa vitesh në institucione publike dhe jo-publike të arsimit të lartë. Me qëllim që vlerësimi të jetë i drejtë dhe i paanshëm, në të gjitha provimet e programit Bachelor në "Mami" përdoret korrigjimi i tezave me sistemin Clean-score. Rezultatet jepen në kohë reale, ndërsa notat publikohen brenda afateve të përcaktuara nga rregullorja përmes sistemit Pitagora. Evidenca: - <i>Shtojca 1.6 Marrëveshja me rash për sistemin elektronik pitagora.pdf.</i> - <i>Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik pitagora.pdf.</i> - <i>Shtojca 2.18; Kontrata AADF me UK</i> - <i>Shtojca 2.18.2; Model testimi clean score</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi, dhe mund të jetë i shkruar, me gojë ose i kombinuar, në varësi të lëndës. Provimi është i mbikëqyrur nga një komision i përbërë nga dy pedagogë, të cilët janë të pranishëm gjatë zhvillimit të tij, në përputhje me numrin e studentëve dhe sallën në dispozicion.

	Teza e provimit hartohet nga pedagogu që ka zhvilluar leksionet, kontrollohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Në syllabuset e lëndëve janë përcaktuar detyrimet e studentëve, duke përfshirë mënyrën e vlerësimit të vazhduar, raportet e vlerësimit, detyrat e kursit, laboratorët dhe frekuentimin. Studentët informohen gjithashtu për temat që do të mbulohen në provim, formatin e pyetjeve dhe materialet që do të përdoren gjatë lëndës. GVJ u njoh me formatin e fletës së provimit dhe procedurën e ndjekur për hartimin, korrigjimin dhe vlerësimin përfundimtar. Evidenca: - Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset). - Shtojca 2.18; Kontrata AADF me UK - Shtojca 2.18.2; Model testimi clean score
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/fëdback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Në rregullore përcaktohen qartë detyrimet që lidhen jo vetëm me ndjekjen e procesit mësimor por dhe me numrin e ECTS-ve teoriko-praktike dhe llojin e lëndëve që studenti duhet të ketë të plotësuara para futjes në një sezon provimi. Kur provimi kryhet me gojë vlerësimi shoqërohet me komente dhe këshillime të studentit për performancën e arritur në provim. Ndërsa në provimet me shkrim komentet dhe sugjerimet kryhen në seancën e komunikimit të rezultateve. Në këto seanca pedagogu i mundëson studentit, nëse dëshiron, të shikojë rezultatet e provimit, bazuar në Rregulloren e UK, Rregulloren e FSHNH dhe Rregulloren e Programit të studimit. Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në sistemin Pitagora. Evidenca:

	- <i>Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik pitagora.pdf.pdf</i> - <i>Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - <i>Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i> - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Përdorimi i materialeve të ndaluara, kopjimi dhe veprime të tjera të tilla nuk lejohen. Në syllabuset e lëndëve është përcaktuar kodi i etikës, ku detajohen veprimet që janë të ndaluara për studentët, duke përfshirë kopjimin dhe plagjiaturën. Komisioni i provimeve siguron transparencë maksimale dhe nuk lejon asnjë abuzim nga studentët, duke parandaluar kopjimin dhe çdo formë tjetër që mund të deformatë vlerësimin e drejtë që secili student meriton. Për punimet e detyrave të kursit dhe diplomave, aplikohen verifikime nëpërmjet programeve antiplagjiaturë. Evidenca: - <i>Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).</i> - <i>Shtojca 1.19; Rregullore e Këshillit të Etikës UK</i> - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Studentët informohen mbi rezultatet e provimeve brenda afateve ligjore të përcaktuara nga Rregullorja e programit të studimit. Korrigjimi i provimeve bëhet me sistemin Cleanscore, i cili kodifikon automatikisht rezultatet 30-60 minuta pas mbarimit të provimit. Rezultatet publikohen menjëherë online në faqen përkatëse https://cleanscore.al/arkiva. <i>Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe një pikë e fortë e këtij programi studimi.</i> Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimeve, dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve

	brenda afatit të përcaktuar. Komisioni cakton një ditë për dhënien e rezultateve dhe shqyrtimin e ankesave lidhur me vlerësimin. Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe kanë deklaruar se vlerësimi është i drejtë dhe në përputhje me rregulloren e provimeve. Rezultatet e provimeve u komunikohen studentëve në mënyrë konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistemin Pitagora. Studentët kanë të drejtën e ankimit, i cili parashikohet dhe rregullohet nga rregullorja, dhe shqyrtohet nga komisioni përkatës i ngritur nga njësia përgjegjëse. Procesi mbyllet me dorëzimin e fletës së notave në sekretari. Gjithashtu, studenti ka të drejtën të kërkojë rishikimin e notës. Evidenca: - <i>Shtojca 2.18; Kontrata AADF me UK</i> - <i>Shtojca 2.18.2; Model testimi clean score</i> - <i>Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik pitagora.pdf.</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtën të njihen me rezultatet e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim, si dhe kanë mundësinë të kontestojnë vlerësimin në rast se nuk janë dakord me të. Ata kanë të drejtën të njihen me pikët e vlerësimit të tezës, sipas nenit 85 të Rregullorës së UK. Në rast se janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nëse ndjehen të vlerësuar padrejtësisht, studentët mund të ankohen. Ankesa duhet të bëhet me shkrim brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë pas dhënies së rezultatit për provimin me shkrim. Ankesa duhet të drejtohet tek Dekani i Fakultetit, i cili vlerëson nëse ankesa është e drejtë dhe ia përcjell për shqyrtim departamentit përkatës. Kjo e drejtë për ankesa është e parashikuar në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit, duke mundësuar që studenti të njihet me vlerësimin, të ankimohet për të dhe të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit. Evidenca: - <i>Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - <i>Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i>

	- <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik pitagora.pdf.</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas nenit 83 të Rregullorës së UK, çdo ankimim për vlerësim shqyrtohet pasi kalon nga përgjegjësi i departamentit dhe dërgohet te Dekani i Fakultetit. Dekani, me propozim nga Përgjegjësi i Departamentit, vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe mund të caktojë ridhënien e provimit brenda ditës ose të nesërmen pas përfundimit të tij. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Nëse studenti nuk është i kënaqur me sqarimin e komisionit, ai ka të drejtën të kërkojë rishikim të testit nga një komision tjetër, i cili ngrihet me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit, pasi analizon pretendimet dhe argumentet e studentit. Pas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni është i detyruar të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem dhe në sekretarinë mësimore. Studentit i vihet në dispozicion rregullorja e programit të studimit, e cila përshkruan procedurën e ankimimit. Për çdo sqarim të mëtejshëm, studenti mund t'i drejtohet koordinatorit të programit ose përgjegjësit të departamentit deri në sqarimin e çdo problematike që mund të ketë. Evidenca: - <i>Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i>

Konkluzione	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Vlerësimi bazohet në meritë. FSHNH ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Duke u nisur nga lëndët që zhvillohen gjatë tre viteve akademike, rezulton se programi aktual i studimit ngjason më shumë me një program të profilit "Infermier i Përgjithshëm", sesa me një program specifik të profilit "Mami". Struktura e lëndëve teorike dhe praktike, përqendrimi në përkujdesjen e përgjithshme dhe mungesa e theksuar e përmbajtjeve të specializuara në fushën e obstetrikës dhe shëndetit të gruas përforcojnë këtë përafrim. Në këtë kontekst, Grupi i Vlerësimit rekomandon rishikimin e programit mësimor me qëllim përafrimin e tij me programin e studimit për profilin "Mami", në përputhje me kërkesat e VKM nr. 823, datë 28.12.2023, si dhe me Direktivën 2005/36/KE të Bashkimit Evropian, e cila përcakton standardet për arsimin dhe trajnimin profesional në këtë fushë. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet një kombinimi orësh teorike dhe praktike, duke përfshirë leksione, seminare, praktika laboratorike, detyra kursi, prezantime, si dhe praktika mësimore klinike dhe profesionale. Ky angazhim i shumëfishtë kontribuon në formimin e gjithanshëm të studentëve dhe i ofron ata njohuri

	të thelluara për studimin e patologjive. Evidenca: - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset). - https://www.zf.uni-lj.si/images/ANG/BA_-_predmetnik_20-21_jan.pdf - https://projects.tuni.fi/app/uploads/2020/12/2a61af88-introduction-ljubljana-university.pdf
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi Bachelor në "Mami" përfshin lëndë si teknologjia e informacionit, etikë dhe deontologji, legjislacion, dhe statistikë mjekësore, të cilat zhvillojnë aftësi të veçanta të studentët në fushat e teknologjisë së informacionit, shkencave humane, sociale dhe të komunikimit. Evidenca: - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).
Kriteri 3. Kompetencat	Në fund të lëndës, pedagogët informojnë dhe orjentojnë

dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	studentët për çështjet më të rëndësishme. Staf i akademik raportoi se zhvillon konsultime me studentët në orën e fundit të lëndës. Në javën e fundit të semestrit studentët orientoohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit bachelor "Mami" integron të rehat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Në fund të praktikës klinike dhe profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët. Institucioni ka hartuar një raport vjetor, që plotëson stafi akademik në fund të semestrit dhe ku specifikohen objektivat e arritura, literatura e përdorur, frekuentimi, realizimi i programit etj. <i>Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe GVJ e konsideron se pikë të fortë.</i> Studentët raportuan se zhvillojnë konsultime me pedagogët. Evidenca: - Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset). - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	GVJ evidentoi se, si gjatë vizitës dhe takimit me strukturat e Universitetit, ashtu edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, laboratorët rezultuan të pamjaftueshëm në pajisje për të garantuar zhvillimin e praktikave të nevojshme për studentët e programit në "Mami". Evidenca:

Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	- Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - Shtojca 4.8; Webfaqja e UK - Shtojca 4.11; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në kriterin 5 GVJ evidenton pavarësisht numrit të aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të programit të përgjithshëm të shëndetit, në dokumentacion evidentohet vetëm pjesëmarrja në nisma sensibilizuese si ato për diabetin apo autizmin. Nuk paraqitet një evidencë e qartë që këto aktivitete janë të fokusuara specifikisht në programin e Mamisë. Për rrjedhojë, ky kriter nuk mund të konsiderohet i plotësuar në mënyrë të mjaftueshme për programin e studimit në "Mami". Evidenca: - Shtojca 4.11; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA - Shtojca 4.8; Webfaqja e UK - Shtojca 4.9; Webfaqja e FSHNH - Takim me stafin akademik.
Konkluzione	GVJ evidenton që programi mësimor në të ardhmen deri në vitin 2027, duhet të përafrohet me " VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023: PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR". GVJ evidenton që programi i përafrohet më shumë programit Infermieri e Përgjithshme sesa programit Mami. Në kriterin 5 GVJ evidenton që përveç aktiviteteve në kuadër të sensibilizimit të diabetit apo autizmit, nuk paraqitet një evidencë

	që të plotësohet ky kriter.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Bazuar në <i>Nenin 108, "Rregullore Organizimit dhe Veprimtarisë Mesimore, Kërkimore Shkencore" e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë</i> si dhe <i>Neni 90 në Rregulloren e UNIKO</i>, në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet me provim formimi ose me temë diplome, sipas përcaktimeve të bëra në këtë rregullore. Diploma nënshkruhet nga dekani i fakultetit përkatës dhe rektori i universitetit, dhe nënshkrimi i rektorit shoqërohet me vulën zyrtare të universitetit. Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet certifikata "Medalje e Artë". Për studentët që gjatë studimeve kanë marrë mbi 70% të notave 10 dhe pjesën tjetër vetëm 9, jepet certifikata "Student i Shkëlqyer". Studentëve që në përfundim të studimeve kanë mesataren e përgjithshme mbi 8, u shënohet emri në Librin e Nderit të Universitetit. Studenti nuk lejohet të japë Provimin Përfundimtar nëse nuk ka shlyer më parë të gjitha detyrimet (nuk ka marrë nota kaluese në të gjitha provimet e disiplinave të Programit të Studimit). Kjo bazohet në <i>Nenin 73, pika 2, të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"</i>. Provimi i Formimit të Përfundimtar bëhet me kontroll njohurish dhe është i orientuar nga fondi i pyetjeve të Licencës së profesionit. Studentët me mesatare mbi 7 (dy vitet e para të studimit) mund të zhvillojnë provimin e formimit me "Temë". Në këtë rast, ata bëjnë përcaktimin e temës në bashkëpunim me pedagogët udhëheqës. Po ashtu, studenti do të njihet më parë me mënyrën e hartimit të tezës dhe me skemën e zhvillimit të Provimit të Formimit të Përfundimtar. Studentët nota mesatare e të cilëve është nën 7 në 4 semestrat e 1-rë e shlyejnë detyrimin përfundimtar me provim.

	Detyrimet përmbyllëse kanë në total 7 kredite. Evidenca: - <i>Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - <i>Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i> - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas Nenit 90 të Rregullores së UNIKO, studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar. Neni 70, pika 3 e Statutit të UNIKO përcakton që në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer. Modalitetet e zhvillimit të provimit final jepen në aktet e brendshme të institucionit dhe për të fituar të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë duke marrë kreditet e nevojshme. Diplomimi realizohet në sezone dhe për studentët që nuk diplomohen në sezonin e diplomimit të verës mund të diplomohen në sezonin pasardhës të vjeshtës. Pedagogu mbështetet në Manualin e Hartimit të Temës së Diplomës për procesin e hartimit të temës, duke udhëzuar studentin mbi strukturën, metodologjinë dhe kërkesat akademike që duhen ndjekur. Ky manual shërben si udhëzues për të siguruar një punim shkencor të rregullt dhe në përputhje me standardet e institucionit. Evidenca: - <i>Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Shtojca 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës</i>

	- <i>Takim me studentët.</i> - <i>Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan S. Noli'.pdf.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Studenti ka të drejtë të mbrojë diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit. Vlerësimi final i studentëve bëhet përmes provimit final, i cili realizohet para një komisioni të posaçëm për provimin dhe një komisioni për mbrojtjen me temë. Këto komisione ngrihen me propozim të drejtuesit të departamentit dhe miratohen nga dekani i FSHNH në nivel Fakulteti. Studentëve u vihen në dispozicion materialet e nevojshme në funksion të provimit final. Temat e diplomës propozohen nga pedagogët përkatës dhe bëhen të ditura për studentët para zhvillimit të provimit. GVJ konstaton që nuk ka evidencë të dokumentuar mbi grupet e lëndëve që përfshihen në provimin final, gjë që e bën të vështirë të vlerësohet përmbajtja dhe përfaqësueshmëria e tij në raport me programin e studimit. Evidenca: - <i>Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Shtojca 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi	Studentët asistohen nga pedagogët në procesin e hartimit të temës së diplomës përmes zhvillimit të seancave konsultuese, të cilat përbëjnë orë pune të dedikuara për të ndihmuar në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjinë e hartimit dhe shkrimit të punimit, si dhe në teknikat e prezantimit të tij. Konsultimet zhvillohen nga pedagogu udhëheqës i temës dhe kanë një qasje interaktive, duke mundësuar diskutime dhe orientim të vazhdueshëm mbi përmbajtjen dhe cilësinë e punimit. Institucioni u garanton studentëve të gjitha kushtet e nevojshme për realizimin e pjesës teorike të temës së diplomës, duke vënë në dispozicion infrastrukturën akademike dhe burimet shkencore të nevojshme. Gjithashtu, u mundësohet mbështetje për mbledhjen e të dhënave dhe

është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	realizimin e testeve në institucionet shëndetësore me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, duke siguruar kështu cilësinë dhe saktësinë e informacionit të përfshirë në punimin e diplomës dhe rritjen e nivelit akademik të punimeve të realizuara nga studentët. Bazuar tek GVB në vlerësimin e procesit të hartimit të temës së diplomës, evidentohen praktika të mira në aspektin e mbështetjes akademike dhe organizimit të procesit konsultativ. Evidencat: - <i>Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i> - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Shtojca 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ evidenton që punohet për të ndihmuar studentët, (kur u pyetën nga takimi me studentët) por nuk paraqitet evidencë e dokumentuar, që ndonjë nga lektorët të konkretisht studentët në hartimin e pyetësorëve apo kryerjen e matjeve dhe analizave për qëllime kërkimore, gjë që do të përforconte më tej cilësinë e procesit studimor. Evidenca: - <i>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023</i> - <i>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024</i> - <i>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025</i> - <i>Shtojca 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.</i> - <i>Shtojca 2.10.1; Marrëveshje bashkëpunimi të FSHNH</i> - <i>Shtojca 2.10.2; Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale;</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm	Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë nga

përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	anëtarët e komisionit përkatës. Pas vlerësimit, procesverbali dorëzohet në sektorin e studimeve dhe sektorin e TIK, i firmosur nga anëtarët dhe kryetari i komisionit. Korrigjimi i provimit kryhet në mënyrë anonime, pa kodim të identitetit të studentit. Pas përfundimit të korrigjimit, sekretaria përpilon dhe publikon rezultatet, duke siguruar transparencë dhe saktësi në vlerësim. Evidenca: - <i>Shtojca 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës</i> - <i>Shtojca 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK</i> - <i>Shtojca 2.18 Kontrata aadf me Univerisitetin F. S. Noli Korcë.pdf.</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën përkatëse dhe suplementin e diplomës, sipas parashikimeve të nenit 70, pika 3 të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli" dhe Nenit 90 të Rregullores së programit të studimit. Përveç diplomës dhe suplementit, studentët marrin një kopje të programit të studimit që kanë përfunduar në ciklin e parë të studimeve (Bachelor). Kopjet e dokumenteve të studentëve ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe akademike. Informacioni mbi studentët, përfshirë regjistrin themeltar dhe regjistrin e arritjeve akademike, plotësohet dhe ruhet sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara nga legjislativa dhe politika e institucionit. Evidenca: - <i>Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i> - <i>Shtojca 2.5.4; Modeli i diplomës & suplementi i programit të studimit në bachelor "Mami"</i> - <i>Shtojca 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK</i> - <i>Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen , ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.pdf.</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me	Dokumentacioni i studentëve për periudhën e studimeve, nga hyrja deri në përfundim, mbahet, përpunohet dhe ruhet sipas

legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	rregullave dhe procedurave përkatëse. Ky proces siguron mundësinë e shërbimit të shpejtë për kërkesat e studentëve, siç janë transferimi i studimeve, hartimi i vërtetimeve, listave të notave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme. Diplomat e studentëve regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve. Kjo siguron që informacioni mbi diplomimin e studentëve është i dokumentuar dhe i njohur në nivel shtetëror. Përsa i përket ruajtjes së dokumentacionit, kopjet e tij ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe janë të disponueshme për studentët, sipas kërkesës, përmes sekretarisë mësimore. Informacioni mbi studentët (regjistri themeltar, regjistri i arritjeve akademike) ju vu GVJ në dispozicion nga sekretaria mësimore gjatë vizitës në institucion. Evidenca: - <i>Shtojca 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK</i> - <i>Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen , ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.pdf.</i> - <i>Takim me sekretarinë mësimore.</i>			
Konkluzione	<i>Procesi i diplomimit realizohet me anë të provimit përfundimtar të formimit, në përfundim të vitit të tretë akademik, Provimi i diplomës bëhet në dy sesione diplomimi të cilat përcaktohen nga Dekani i Fakultetit. Studenti që nuk paraqitet ose vlerësohet negativisht në sesionin e parë të provimeve, ka të drejtë të paraqitet në provim në sesionin e ardhshëm. Departamenti përcakton datën e zhvillimit të provimit të diplomes. Detyrimet përmbyllëse kanë në total 7 kredite Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës.</i> <i>GVJ evidenton që nuk ka evidencë se cilat grup lëndë janë të përfshira në provim e diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

				X
--	--	--	--	---

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																		
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Në bazë të evidencave dhe syllabuseve të paraqitura në RVB, evidentohet prania e një kordinatori. Personeli akademik me kohë të pjesshme mbulon kryesisht lëndët <table><tr><th rowspan="2">Departamenti i Infermierisë</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td></td><td>1</td><td></td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>Dr</td><td>9</td><td>1</td><td>9</td><td>2</td></tr><tr><td>MSc</td><td>9</td><td>21</td><td>9</td><td>18</td></tr><tr><td>Total</td><td>18</td><td>22</td><td>18</td><td>20</td></tr></table> specifike ose është pjesë e personelit që zhvillon ose mbështet praktikat profesionale në mjediset e strukturave spitalore unniversitare ose jashtë tyre. Evidenca: <i>*LIGJ Nr.10 171, datë 22.10.2009 PËR PROFESIONET E RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË</i> <i>*Ligj Nr.9718, datë 19.4.2007. PËR URDHRIN E INFERMIERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.</i> <i>* Takimi me Dekanin, përgjegjës të departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>	Departamenti i Infermierisë	2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr		1		1	Prof.As.Dr					Dr	9	1	9	2	MSc	9	21	9	18	Total	18	22	18	20
Departamenti i Infermierisë	2023-2024		2024-2025																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr		1		1																															
Prof.As.Dr																																			
Dr	9	1	9	2																															
MSc	9	21	9	18																															
Total	18	22	18	20																															
Kriteri 2.	Bazuar në evidencat e paraqitura progami studimit ka  raport të																																		

Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	kënaqshëm PAE/PAK del 69.3% me 30.7%, duke ju referuar ngarkesës 2208 të orëve në auditor për të 3 vitet, ndërsa po ti referohemi ngarkesës totale për të gjitha grupet e seminareve, laboreve dhe praktikave klinike, raporti PAE/PAK del sipas tabelës së mëposhtme; Evidenca: - 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB - 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset) - *Takimi me Dekanin, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Personeli akademik i DI dhe ai i angazhuar në programin e studimit, përbën një nga pikat më të forta të veprimtarisë akademike të DI. Shumica prej personelit akademik kanë nisur karrierën e tyre në këtë fakultet dhe kanë avancuar në karrierën e tyre falë politikave mbështetëse të institucionit për promovimin e personelit akademik. Kjo mbështetje ka krijuar tek personeli një klimë pozitive e cila reflektohet në qëndrueshmërinë afatgjatë të personelit akademik. Por ajo që vlen të theksohet është që ka mungesë të një profesioneje Mami. Evidencat: - 4.3; Kontratë pune staf akademik efektiv - 4.3.1; Kontratë pune personeli ndihmës akademik - 4.2; Kontratë individuale e punës, për personelin akademik me kohë të pjesshme - 1.13; Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik - 1.14; Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit - *Takimi me stafin akademik
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që	Në evidencat e sjella thuhet që bazohet në kritere të përgjithshme dhe specifike për vlerësimin dhe përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur akademik, por që nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për të rekrutuar specialist Mami. Evidencat: - 1.13; Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik - 1.14; Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit - 4.3; Kontratë pune staf akademik efektiv - 4.3.1; Kontratë pune personeli ndihmës akademik

garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	- 4.2; <i>Kontratë individuale e punës, për personel akademik me kohë të pjesshme</i> - <i>Takimi me perfaqesuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në evidencën e sjellë mbi angazhimin e personelit ndihmës akademik, nuk paraqiten në rregulloren e programit apo në rregullore të tjera përshkrimi i punës. Gjithashtu nuk paraqitet nga evidencat që ka personel ndihmës akademik për laboratorët. Evidenca: - 2.14; <i>Struktura dhe Organigrama e UK</i> - <i>*Vizita në institucion.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislationin në	Në bazë të evidencave thuhet që procedurat e administrimit të informacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative kryhen në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Nëpërmjet zyrës së burimeve njerëzore administrohen të gjitha të dhënat mbi personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Dosjet e personelit përditësohen në mënyrë periodike zakonisht në fillim të çdo viti akademik GVJ evidenton që nuk janë në format digjital, bioshort në website. Evidencat: - 1.2; <i>Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i>

fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	- 1.4; Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore - 1.9; Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale - 4.3; Kontratë pune staf akademik efektiv - 4.2; Kontratë individuale e punës, për personel akademik me kohë të pjesshme - *Takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe stafin akademik
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas	Sipas evidencave Universiteti F. S. Noli Korçë ka marrëveshje (Memorandume) bashkëpunimi me shërbime spitalore dhe njesi shëndetësore të ndryshme. Në këto institucione studentët e këtij programi studimi realizojnë praktikën, marrin të dhënat për punimin e diplomës apo realizojnë kërkim shkencor për veprimtari të caktuara të procesit mësimor. Staf i kualifikuar i këtyre institucioneve drejtuesit e pavioneve, kryeinfermierët, mjekë sipas specialiteteve dhe infermierë me eksperiencë dhe ekspertizë të spikatur aplikojnë sipas procedurave ligjore dhe miratohen si pedagogë me kohë të pjesshme pranë UK. Ky staf i miratuar ka të drejtën dhe angazhohet nga departamenti për të qenë drejtues i praktikave klinike, mësimore e profesionale dhe angazhohet të ndihmojë studentët në grumbullimin e të dhënave në punën e tyre shkencore. GVJ eidenton që nuk ka një evidencë mbi numrin e studentëve për çdo grup praktike dhe cilat praktika udhëheqin çdo specialist në kurset përkatëse sipas <u>VENDIM. Nr. 41, datë 24.1.2018. PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË.</u> Vihet re që në evidenca nuk ka grafik të dedikuar të orarit mësimor të programit Mami dhe grafikut të praktikave. Duhet të rritet numri i mbikëqyrësve të praktikave profesionale GVJ nga vizita në institucion eidentoi se këto laboratore kanë nevojë për investime në pajisje për një zhvillim dhe realizim normal të

natyrës së programit të studimit.	praktikave. Evidencat: - 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale. - 2.10.1; Marrëveshje bashkëpunimi të FSHNH - 2.10.2; Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale; - 4.2; Kontratë individuale e punës, për personel akademik me kohë të pjesshme - 4.5.1; Orari, grafiku i praktikave - 3.16.1; Udhëzues & rregullore e praktikave mësimore, klinike-profesionale - 3.16.2; Udhëzues vlerësimi i praktikave mësimore, klinike-profesionale. - Takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore - Takimi me studentët, me stafin akademik, përgjegjës in e departamentit dhe stafin mbikqyrës në praktika profesionale.
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ evidenton që në bazë të evidencave thuhet që personeli mbikqyrës i praktikave PAK zhvillon orët praktike me studentët me korrektësi sipas programit të praktikës, mban listëprezencën, i angazhon studentët në veprimtari praktike, merr pjesë në vlerësimin e studentëve mbi praktikën e zhvilluar. Evidenca: - 3.16.1; Udhëzues & rregullore e praktikave mësimore, klinike-profesionale - 3.16.2; Udhëzues vlerësimi i praktikave mësimore, klinike-profesionale. - 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - 4.5.1; Orari, grafiku i praktikave - 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset). - *Takimi me studentët, me stafin akademik, përgjegjës in e departamentit dhe stafin mbikqyrës në praktika profesionale.
Konkluzione	DI nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për të rekrutuar specialist Mami. Në evidencën e sjellë mbi angazhimin e personelit ndihmës akademik, nuk paraqiten në rregulloren e programit apo në rregullore të tjera

<i>përshkrimi i punës. Gjithashtu nuk paraqitet nga evidencat që ka personel ndihmës akademike për laboratorët</i> <i>GVJ evidenton që nuk janë në format digjitale, bioshort në website nuk janë.</i> <i>GVJ evidenton që nuk ka një evidencë mbi numrin e studentëve për çdo grup praktike dhe cilat praktika udhëheqin çdo specialist në kurset përkatëse sipas VENDIM. Nr. 41, datë 24.1.2018. PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA. INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË.</i> <i>Vihet re që në evidenca ka grafik të dedikuar të orarit mësimor të programit Mami dhe grafikut të praktikave. Duhet të rritet numri i mbikëqyrësve të praktikave profesionale.</i> <i>GVJ nga vizita në institucion evidentoi se këto laboratore kanë nevojë për investime në pajisje për një zhvillim dhe realizim normal të praktikave.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Sipas evidencave thuhet që Universiteti F. S. Noli Korçë funksionon si një njësi e plotë dhe pa dallim ndërmjet fakulteteve apo departamenteve. Institucioni ka vënë në dispozicion të leksioneve auditorët me kapacitetin më të madh në FSHNH në Fakultetin e Edukimit, Fakultetin Ekonomik për realizimin e këtyre orëve mësimore. Orët e laboratorëve dhe seminareve zhvillohen në mjedise specifike të dedikuara për modulet dhe lëndët përkatëse në sallat dhe laboratorët e godinës B të FSHNH. Mjediset e laboratoreve janë të mjaftueshme për numrin e studenteve që mbulojnë, dhe pajisjet paraqiten mjaftueshëm për një sigurim normal të praktikave laboratorike. Evidenca:

	- 4.5; <i>Model orari mësimor</i> - 4.6; <i>Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike</i> - <i>*Takimi me studentët, me stafin akademik, përgjegjës të departamentit.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ vërejtë që mjediset e laboratorëve janë të kompletuara me pajisje laboratorike, në të cilat studentët praktikisht realizojnë procedurat praktike në mënyrë të mjaftueshme. Evidenca: - 4.6; <i>Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike</i> - <i>*Takimi me studentët dhe me stafin akademik.</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ vërejtë që mjediset e laboratorëve janë të kompletuara me pajisje laboratorike, në të cilat studentët praktikisht realizojnë procedurat praktike në mënyrë të mjaftueshme. Evidenca: - 4.6; <i>Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike</i> - <i>Vizita në institucion</i> - <i>Takimi me studentët dhe me stafin akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Sipas evidencave thuhet që FSHNH në përbërjen e vet ka departamentin e informatikës me programe e studimi të dedikuara të teknologjisë së informacionit, por jo vetëm krijohet dhe ekziston mundësia që studentët të përdorin këto mjedise (2 lab teknologji informacioni dhe 1 lab biokimi) të pajisura me kompjutera dhe programe profesionale. GVJ vëren se ka programe profesionale për zhvillimin e praktikave në kuadër të simulacioneve apo rasteve studimore/klinike.

	Evidenca: - 2.7.1; <i>Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023</i> - 2.7.2; <i>Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024</i> - 2.7.3; <i>Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025</i> - 4.6; <i>Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike</i> - 4.5; <i>Model orari mësimor</i> - <i>Vizita në institucion</i> - <i>Takimi me studentët dhe me stafin akademik</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vërejtë që mjediset e laboratorëve janë të kompletuara me pajisje laboratorike, në të cilat studentët praktikisht realizojnë procedurat praktike në mënyrë të mjaftueshme.</i> <i>GVJ vëren se ka programe profesionale për zhvillimin e praktikave në kuadër të simulacioneve apo rasteve studimore/klinike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura e sugjeruar gjendet në formë fizike por në format elektronike nuk evidentohet që është në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (në shqip). Studentët dhe pedagogët citohet që komunikojnë edhe nëpërmjet platformave elektronike për materiale dhe informacion, por nuk paraqesin një evidence të tilla si psh google classroom, moodle, apo sisteme të ngjashme. Evidenca: - 2.8; <i>Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).</i> - <i>Takimi me studentët dhe stafin akademik</i> - <i>Vizita në institucion, bibliotekë.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse	GVJ evidenton që ka nevojë për përmirësim në

duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	dokumentacion në lidhje me tekstin e miratuar në department dhe ka një praktikë të shkruar për miratimin e planeve mësimore, psh duke kaluar nga titullari lëndës, koordinatori programit apo dhe drejtuesi i grupit mësimor/shkencor. Evidenca: • 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset). Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Kurrikuave dhe NJSBC
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e FSHNH, e cila për arsye objektive të përkohëshme është në proces ristrukturimi, krijon një boshllëk në shfrytëzimin e librit fizik dhe mjediseve për studim. Evidencat: - 3.12; Raport informues i bibliotekës shkencore të UK mbi botimet dhe përditësimet e literatures - 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library - 3.13; Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës FSHNH - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët. - Vizita në bibliotekën e DI-së
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët dhe vizita në bibliotekën e DI-së GJV konstatoi se studentët dhe stafi përdorin si librat hard-copy në bibliotekë si dhe bibliotekën online. (https://ulibrary.rash.al/). Biblioteka e FSHNH, e cila për arsye objektive të përkohëshme është në proces ristrukturimi, krijon një boshllëk në shfrytëzimin e librit fizik dhe mjediseve për studim, edhe pse kompensohet nga biblioteka qendrore. Anëtarësimi në bibliotekë është falas, anëtarë pajiset me kartelë dhe librezë antarsimi, biblioteka është e pajisur dhe me fondin elektronik, i cili disponohet online falë bashkëpunimit me AADF, studentët mund të përdorin edhe bibliotekën J-store, pa pagesë dhe pa limit. Evidenca: - 3.12; Raport informues i bibliotekës shkencore të UK mbi botimet dhe përditësimet e literatures - 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library - 3.13; Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës FSHNH - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin

	<i>akademik, studentët.</i> - <i>Vizita në bibliotekën e DI-së</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni i garanton shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë studentët në biblioteka online në fushën e programit të studimit bachelor në “Mami”. Nga vizita u vërejt prania e studentëve në sallën e bibliotekës duke shfrytëzuar kryesisht bibliotekën online . Evidenca: - 3.12; Raport informues i bibliotekës shkencore të UK mbi botimet dhe përditësimet e literatures - 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library - 3.13; Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës FSHNH - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët. - Vizita në bibliotekën e DI-së
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka qendrore e universitetit është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje teknike, të cilat mundësojnë që studentët të punojnë dhe hulumtojnë pa kufizim në bibliotekën qendrore. Ndërkohë që biblioteka e FSHNH është përkohësisht jashtë shërbimit, por ajo përmban një fond të rëndësishëm dhe të konsiderueshëm librash, si dhe do të krijojë pas restaurimit, shfrytëzimin e fondit fizik dhe bibliotekës online. Evidenca: - 3.12; Raport informues i bibliotekës shkencore të UK mbi botimet dhe përditësimet e literatures - 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library - 3.13; Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës FSHNH - Takimi me stafin akademik, studentët. - Vizita në bibliotekën e DI-së
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe	Nga takimi me stafin akademik, studentët dhe vizita në bibliotekën e UNIKO GVJ konstatoi se biblioteka e FSHNH, e cila për arsye objektive të përkohëshme është në proces ristrukturimi, krijon një boshllëk në shfrytëzimin e librit fizik dhe mjediseve për studim. Deklarohet nga stafet që kompensohet pjesërisht nga biblioteka qendrore.

kapacitetit të saj.	Evidenca: - 3.12; Raport informues i bibliotekës shkencore të UK mbi botimet dhe përditësimet e literatures - 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library - 3.13; Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës FSHNH - 4.8; Webfaqja e UK - *Takimi me stafin akademik, studentët. - *Vizita në bibliotekën e UNIKO-së
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nga takimi me stafin akademik, thuhet që bëjnë kërkesa të përvitshme për tituj librash apo revistash shkencore për pasurimin e bibliotekës. Evidencat: - 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022. - 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023. - 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024. - 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022 - 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023 - 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024 - 3.13; Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës FSHNH - 3.12; Raport informues i bibliotekës shkencore të UK mbi botimet dhe përditësimet e literatures - 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library - *Takimi me stafin akademik, studentët. - *Vizita në bibliotekën e DI-së
Konkluzione	<i>Studentët dhe pedagogët citohet që komunikojnë edhe nëpërmjet platformave elektronike për materiale dhe informacion, si psh google classroom, moodle, apo sisteme te ngjashme.</i> <i>GVJ evidenton që ka nevojë për përmirësim në dokumentacion në lidhje me tekstet e miratuara në department dhe ka një praktikë të shkruar për miratimin e planeve mësimore, psh duke kaluar nga titullari lëndës, koordinatori programit apo dhe drejtuesi i grupit mësimor/shkencor.</i>

	<i>Nga takimi me stafin akademik, studentët dhe vizita në bibliotekën e UNIKO GVJ konstatoi se biblioteka e FSHNH, e cila për arsye objektive të përkohëshme është në proces ristrukturimi, krijon një boshllëk në shfrytëzimin e librit fizik dhe mjediseve për studim. Deklarohet nga stafet që kompensohet pjesërisht nga biblioteka qëndrore.</i> <i>Nga takimi me stafin akademik, bëjnë me dije që bëjnë kërkesa të përvitshme për tituj librash apo revistash shkencore për pasurimin e bibliotekës, por është dhe fakti që ato janë online dhe studentët mund të aksesojnë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi se institucioni ka një platformë të tijën, specifikisht platforma PITAGORA, me funksione të shumëfishta në administrimin e aktivitetit akademik, mësimor dhe trajnues. Kjo platformë lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit dhe UNIKO e disponon. Evidencat: - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; - 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora; - *Takimi me përgjegjësën e departamentit, stafin akademik, studentët. - *Vizita në sekretarinë mësimore
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik,	Nëpërmjet sistemit të brendshëm Pitagora administrohet informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me hedhjen e notave dhe gjenerimin e procesverbalit. Evidencat: - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;

personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	- 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora; - Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, studentët. - Vizita në bibliotekën e DI-së
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ evidentoi që në respekt të kuadrit ligjor dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sistemi i menaxhimit garanton dhe siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente, për të gjithë personelin dhe studentët e Programit të studimit Bachelor në “Mami”. Evidencat: - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; - 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora; - *Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, studentët. - *Vizita në bibliotekën e DI-së - *Takimi me Zyrën e sekretarsë mësimore
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nëpërmjet sistemeve të menaxhimit, Pitagora mundësohet komunikimi interaktiv, i shpejtë dhe i saktë i informacionit në lidhje me procesin mësimor, vlerësimet, kreditet. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Uniko ka të instaluar paketën OFFICE 365 me emaile zyrtare për stafin dhe studentët dhe ofron paketën e plotë të OFFICE duke përfshirë edhe Microsoft Teams. Ka një sistem, nëpërmjet një portali të posaçëm, ku studentët informohen jo vetëm me njoftimet për procesin mësimor por edhe për veprimtari të tjera apo informacione të nevojshme që lidhen me kërkimin shkencor, aktivitetet studentore, mobilitetet etj. Ka një sistem, ku të dhënat në lidhje me veprimtaritë, leksionet, detyrat dhe materiale të tjera, personeli akademik dhe studentët mund të kryejnë nëpërmjet nje platforme digjitale. Evidencat: • 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;

	• 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora; • 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK *Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët. *Vizita në Sekretarinë mësimore e DI-së			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në saj të dixhitalizimit, sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, si edhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale, për organet drejtuese dhe autoritetet drejtuese të UK. Evidencat: - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; - 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora; - 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK - *Vizita në Sekretarinë mësimore e DI-së - *Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët. - *Takimi me përfaqësuesit Zyrës së burimeve njerëzore			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në WEB faqen e UK, sipas UNIKO publikohen informacionet që lidhen me Programin e studimit "Mami", personelin akademik, aktivitetet institucionale etj. Por ajo çfarë evidentohet është se nuk ekziston si faqe gjate klikimit sipas evidences se derguar. Evidencat: - 4.8; Webfaqja e UK - 4.9; Webfaqja e FSHNH https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dheshkencave-humane-3/ - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët. - Vizita në Sekretarinë mësimore e DI-së			
Konkluzione	Ka sistem të menaxhimit në lidhje me menaxhimin akademik, ne lidhje me procesin e hedhjes së notave të studenteve në Pitagora.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nuk ka një plan të dedikuar financimi të përshkruar të gjitha kostot e programit të studimit që përfshijnë burimet njerëzore dhe infrastrukture, materialet e konsumit, pajisjet, zhvillimin e praktikave spitalore, pasurimit të bibliotekës, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm. Nga shqyrtimi i evidencave GVJ nuk konstaton praninë e raportit financiar të kostove të njësisë bazë për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi për një cikël të plotë studimi. Evidencat: - 1.7; Rregullore e Drejtorisë Ekonomike; - 1.8; Rregullore e Drejtorisë së Financës (EDE); - 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK; - 1.11; Rregullore e Senatit Akademik; - 1.20; Rregullore e Këshillit të Etikës; - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet	IAL harton plane financimi për programin e studimit. Evidencat: - 1.7; Rregullore e Drejtorisë Ekonomike; - 1.8; Rregullore e Drejtorisë së Financës (EDE); - 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK; - 3.15; Praktika e miratimit të Buxhetit UK - 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - *Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.

financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Konform legjislacionit në fuqi, UNIKO i nënshtrohet në vazhdimësi auditimit periodik të bazuar mbi dokumentacionin. Në UNIKO funksionon Njësia e Auditit të Brendshëm, UNIKO i nënshtrohet periodikisht edhe Auditit të jashtëm. Evidencat: - 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022. - 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023. - 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024. - 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022 - 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023 - 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024 - 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK; - 1.15; Raport i kontrollit të MASR për kapacitetet pritëse të UK 2023-2024 - *Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sipas stafeve në përmbushje të këtij kriteri, njësia bazë njihet me raportin financiar të institucionit, i cili u bëhet me dije anëtarëve të njësisë bazë. Thuhet se raporti është i aksesueshëm edhe në faqen zyrtare, por nuk ka nje evidence te tille te pasqyruar ne raport. Evidencat: - 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022. - 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023.

	- 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024. - 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022 - 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023 - 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024 - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Sipas stafëve UNIKO garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet që kryhen. Evidencat: - 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022. - 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023. - 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024. - 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK; - 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion) - 3.15; Praktika e miratimit të Buxhetit UK - 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.			
Konkluzione	Çdo vit akademik UNIKO harton raportin financiar në nivel institucional. Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nisur nga evidencat, takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC dhe vizita në ambientet e DI-së GVI konstaton se institucioni (senati dhe bordi administrimit) harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Kjo gjë vërehet dhe me verifikimin dhe raportimin e kapaciteteve pritëse të institucionit në fillim të vitit akademik. Evidenca - Statutin e UK Kreu VI, Nenet 46, 50, 61, 63. - Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e Universitetit "Fan S. Noli", Kreu VI, Neni 48, 58, 78, 79, 82, 83 - Rregulloren e Njesisë Kryesore, Kreu III, Nenet 15, 25, 37, 38, 41, 42 dhe 50 (Shtojca 2.2 Rregullore e Njesisë Kryesore). - Rregulloren e programit të studimit "Mami" Evidencat: - 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë • 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 • 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - 2.18.2; Model testimi clean score • 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës

	- 2.18.4; <i>Formulari i vlerësimit të temës së diplomës udhëheqës/opponent</i> - 2.10; <i>Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.</i> - 2.20; <i>Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA</i> - 4.10; <i>Material promovues broshura për promovimin</i> - 2.5.4; <i>Modeli i diplomës & suplementi i programit të studimit në bachelor "Mami"</i> - <i>Vizita në ambientet e DI-së</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	UNIKO/DI ndjek politika dhe procedura si dhe ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë. Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore GVI vuri re se DI bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Shqiptar, nr. 80/2015, statutin e UNIKO siguron barazinë bazuar mbi kriteret dhe procedurat për të gjithë kandidatët për tu regjistruar në Programin e Studimit Bachelor në "Mami". Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Evidencat: - 1.1; <i>Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - 1.2; <i>Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - 2.2; <i>Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i> - 1.6; <i>Manual i sistemit elektronik pitagora;</i> - 1.10; <i>Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK</i> - <i>Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve	GVI në takimin me stafin akademik dhe studentet, si dhe dokumentat e vena në dispozicion, u informua dhe konstatoi se para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen "ditët e informimit të maturantëve". Modalitetet e pranimit në të gjitha programet e studimit përcaktohen me vendim senati në mbështetje të kriterëve kombëtarë të përcaktuara në LAL dhe propozimeve të njësisë bazë për kriteret të veçanta. Kriteret shpallen dhe u bëhen të ditur të gjithë aplikantëve gjatë periudhës së informimit dhe gjithashtu

përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	publikohen në UAlbania. Institucioni bashkëpunon gjatë gjithë kohës me QSHA për përdorimin e sistemit në kohë reale. Programi Bachelor në “Mami” ofrohet vetëm në gjuhën shqipe. Në planifikim e kuotave të pranimit parashikohen edhe kuota për studentë nga trojet. Evidenca: - 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë"; - 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit “Mami” 2022-2023 - 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit “Mami” 2023-2024 - 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit “Mami” 2024-2025 - Takimi me përgjegjësën e departamentit, stafin akademik, studentët, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC, Sekretarinë Mësimore.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Institucioni gjithashtu planifikon kuota për transferim të studimeve nga insitucione të tjera dhe programe të dyta studimi. Kushtet dhe procedura e transferimit të krediteve gjithashtu janë të kuptueshme dhe u bëhen të ditur aplikantëve nga stafi dhe sekretaria mësimore. GVJ konstaton se pranimi i transferimit të studentëve në programin e studimit bëhet në përputhje me procedurat e transferimit të studentëve të UNIKO dhe Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Evidencat: - 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 4.10; Material promovues broshura për promovimin - 4.11; Jeta studentore dhe veprimtaria e QKA - Takimi me përgjegjësën e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon	Para fillimit të vitit akademik Institucioni organizon fushatën e informimit për të gjitha programet e studimit. Institucioni prej vitesh merr pjesë në Panairot Work & Study të organizuar

publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	në rrethe dhe në Tiranë në afatet e përcaktuara nga MAS sipas një kalendari të shpallur paraprakisht, me përfaqësues nga zyra e Informimit dhe Njësitë akademike. Informacion të bollshëm ka dhe në katalogun e universitetit, faqe zyrtare e UNIKO, rrjete të komunikimit social si profili në Facebook/Meta, llogaria në Instagram, numra telefoni në dispozicion, si dhe vë në dispozicion të studentëve materiale informuese si broshura, fletëpalosje duke informuar studentët kandidatë rreth programeve që ofron. Evidencat: - 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ - 4.9; Webfaqja e FSHNH https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencavenatyrore-dhe-shkencave-humane-3/ - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UNIKO/DI harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. UNIKO/DI ndjek një politikë të barabartë pranimi për të gjithë kandidatët qofshin këta me aftësi të veçanta apo përkatësi të ndryshme (studentë romë ballkano egjiptian, studentët me statusin e jetimit, fëmijë të policëve të rënë në detyrë). Kriteret që janë vendosur për këtë kategori janë të njëjta me ato të publikuara nga Ministria e Arsimit në udhëzimin nr.17, datë 30.07.2019. GVJ konstatoi se infrastruktura e DI, e vënë në dispozicion, nuk është përshtatshme për t'u aksesuar si me këmbë ashtu edhe me mjete ndihmëse si rampa, ashensorë etj. për studentët me aftësi ndryshe. Pra nuk sigurohet barazia për të gjithë kandidatët me aftësi të veçanta në ambientet fizike. Evidencat: - 3.19; "Propozim për kuotat & kriteret e pranimit të studentëve". - 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami"

	2024-2025 - Takimi me përgjegjës të departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UNIKO/DI planifikon dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera (nga trojet shqipfolëse). Këto kritere të miratuara me vendim Senati Akademik sipas udhëzimeve të Ministrisë, më pas i dërgohen zyrtarisht Ministrisë së Arsimit dhe për dijeni QSHA. DI nëpërmjet faqes Web, fletëpalosjeve, reklamave televizive, Zyrës së karrierës dhe këshillimit, ofron informacion për mënyrën e ndjekjes së procedurave për regjistrim. Evidencat: - 3.19; "Propozim për kuotat & kriteret e pranimit të studentëve". - 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Takimi me përgjegjës të departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UNIKO/DI ndjek politikë mbështetëse për studentët me aftësi ndryshe, studentët me një prind, fëmijë të policëve të rënë në detyrë, studentë romë dhe ballkano-egjiptian duke i ndihmuar si nga ana ekonomike ashtu dhe për integrimin sa më të mirë të tyre në rastet kur ata e dëshmojnë këtë përkatësi. Për studentët me nevoja dhe statuse të veçanta institucioni ofron lehtësira financiare (bursa studimi), të cilat parashikohen në kontratat individuale të cilat rimbursohen nga buxheti i shtetit për llogari të UNIKO, pas depozitimit të kërkesës në departamentin përkatës. Evidencat: - 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK;

	- 4.7; Njoftimi për përfitimin e bursave - Takimi me përgjegjës të departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.			
Konkluzione	UNIKO/DI ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit bazuar në aktet ligjore. UNIKO, ndjek politikë mbështetëse për studentët romë dhe ballkano-egjiptian duke i ndihmuar si nga ana ekonomike dhe studentët me nevoja dhe statuse të veçanta institucioni ofron lehtësira financiare të cilat parashikohen në kontratat individuale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVI, referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullore të programit të studimit, faqes zyrtare të web si dhe takimit me përfaqësues të tij, konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjithashtu u konstatua se studentët informoheshin nga zyra e karrierës, përgjegjësi i programit të studimit dhe tutori i vitit përkatës në lidhje me rregulloret e shkollës, rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit, pikëzimet, etj. Nuk është i dokumentuar qartë informacioni zyrtar në lidhje me kriteret dhe procedurat që rregullojnë përparimin akademik të studentëve dhe kalimin e tyre nga një vit akademik në tjetrin. Evidencat: - 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023

	- 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Takimi me përgjegjës të departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstaton se DI përmes Zyrës së Sekretarisë Mësimore ofron informacion dhe udhëzime të hollësishme për studentët mbi procedurat, në bazë të kushteve të njohjes dhe transferimit të krediteve. Studentëve i bëhet e ditur se procedurës së ekuivalentimit i nënshtrohen studentët që kanë mbaruar apo kryer pjesërisht programe universitare me orientim mjekësor me module të ekuivalentuara nga komisioni përkates i ngritur nga UNIKO/DI. Evidencat: - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - Takimi me përgjegjës të departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga vizita me studentët se ato informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara dhe prezantimit të pedagogut përkates në orën e parë të mësimit, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit. Evidencat: - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami"

	2024-2025 - 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset). - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; - Takimi me përgjegjës të departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ evidentoi që në planin mesimor është parashikuar në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. GVJ rekomandon që të percaktohen lëndët në rregullore ose të jene në formën e urdhrit nga drejtuesi i njësisë bazë. Evidencat: - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - 2.18.2; Model testimi clean score - 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës - Takimi me përgjegjës të departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e kurrikulës.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Nga takimi me studentët dhe stafi akademik, GVJ konstatoi se studentët dhe gjithë të interesuarit kanë mundësi të marrin informacion për programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese, sekretarisë, stafit akademik dhe përgjegjësit të programit në çdo ditë të vitit dhe vecanërisht në muajin shtator gjatë periudhës së informimit. Në mënyrë periodike duke marrë pjesë në Panairin work & Study të organizuara nga MAS dhe duke organizuar ditët e hapura për maturantët. Duke u nisur nga fakti që regjistrimi kryhet në disa raunde sipas udhëzimeve të MAS, gjatë gjithë kohës së regjistrimeve dhe periudhat midis raundeve konsiderohen ditë të hapura për informacion. Evidencat: - 4.11; Jeta studentore dhe veprimtaria e QKA - 4.10; Material promovues broshura për promovimin - 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ - 4.9; Webfaqja e FSHNH https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dheshkencave-humane-3/

	- Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore. zyrën e kurrikulës, NJSBC-së.			
Konkluzione	Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurë vlerësimit të dijeve, kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UNIKO Informon publikun për programet e studimit që ofron duke organizuar takime të hapura me të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit, fletë palosjeve informuese, informacionit në faqen e webit të universitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Përgjegjësi i programit u jep studentëve gjithë informacionin e detajuar për organizimin e procesit mësimor, kalendarin akademik ku përfshihen datat e fillimit dhe mbarimit të procesit mësimor, periudhat e teorisë dhe praktikës, sesionet e provimeve dhe mbrojtja e diplomës. Nga takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore dhe evidencat GJV konstaton se studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit në mënyra të ndryshme siç janë e-mailet, takimet në Zyrën e Karrieres, stafin akademik, si dhe vënie në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit, ose përmes faqes zyrtare, si dhe mund të aksesojnë në formatin hardcopy dosjen e programit të studimit pranë zyrave të shërbimit të studentëve pranë UNIKO. Evidencat:

	- 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2023-2024 - 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - 4.11; Jeta studentore dhe veprimtaria e QKA - 4.10; Material promovues broshura për promovimin - 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ - 4.9; Webfaqja e FSHNH https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dheshkencave-humane-3/ - Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ bazuar në takimin me drejtues të institucionit, takimi me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimi me studentët mendon se: DI informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në "Mami". Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet web-it. Po ashtu në orën e parë studentët marrin informacion të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodin lëndor, raporti leksion/seminar/ laborator/ praktik, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës etj. Evidencat: - 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023 - 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024 - 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025 - 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2022-2023 - 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Mami"

	2023-2024 - 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Mami" 2024-2025 - 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset). - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; - 3.14; Udhërrëfyesi i studentëve (prezantimi me vitet e para) - 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK - Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, studentet, zyrën e sekretarisë mësimore, zyrene kurrikulave
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e karrierës, NJSBC, zyrën e Kurrikulave GVJ konstaton se institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës nëpërmjet funksionimit të Zyrës së karrierës, duke ju ardhur në ndihmë të gjithë studentëve që vazhdojnë dhe që kanë përfunduar studimet në UNIKO/DI, për të arritur potencialin e tyre maksimal dhe për tu mirëorientuar në tregun e punës. Zyra e karrierës mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale si dhe për t'i njoftuar me mundësi punësimi dhe aktivitete të edukimit në vazhdim që organizohen nga UNIKO si Panairin e Punës. Gjithashtu kanë informacion të vazhdueshëm nga Urdhri Infermierit. Paraqiten të dhëna nga Alumni për punësimet e ardhur nga Udhërat profesionale (UISH). Evidencat: - 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA - 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ - 2.16; Gjurmimi i ecursisë së punësimit (alumni) dhe UISH - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e karrierës, NJSBC, Kurrikulave.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor,	GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që ata informohen hollësisht dhe gjerësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët,

logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	modalitet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spitale. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij në fillim të çdo viti akademik. Evidencat: - 3.14; Udhërrëfyesi i studentëve (prezantimi me vitet e para) - 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA - 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ - 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset). - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore, Karrierës, NJSBC
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që studentët e UNIKO/DI informohen për të gjitha nëpërmjet platformës elektronike (Pitagora) që është një sistem i brendshëm menaxhimi të dhënash ku studentët logohen individualisht me të dhënat e tyre personale dhe mund të marrin çdo informacion që lidhet me performancën e tyre akademike. Në këtë sistem ata futen nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit. Ky akses në platformën Pitagora është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë, nga çdo ambient ku mund të ndodhen. Evidencat: - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; - 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora; - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore, Karrierës, NJSBC.
Konkluzione	UNIKO/DI dhe programi i studimit i siguron infrastrukturën e nevojshme studentëve për marrjen e informacionit të hollësishëm lidhur me organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale, literaturën e nevojshme dhe strukturat ndihmëse. Institucioni mundëson

	përfshirjen e studenteve në një sërë aktivitete informuese në lidhje me kërkesat e punëdhënësve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mësimore mban informacion në lidhje me studentët e regjistruar dhe të diplomuar në të gjitha programet e studimit. Informacioni mbahet sipas udhëzimeve të MAS dhe në koordinim me QSHA në formë fizike dhe elektronike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimi me përgjegjës të departamentit, stafin akademik, zyrën e sekretarisë mësimore, GVJ konstaton se DI disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. Këto të dhëna (statistika të përgjithshme për numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat, studentët e diplomuar dhe të dhënat e punësimit të tyre) mblidhen, përditësohen dhe analizohen nga departamenti, Sekretaria Mësimore, Drejtoria e kurrikulave, Zyra e Karrierës dhe Alumni. Evidencat: - 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë nuk eg - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; - 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK - Takimi me përgjegjës të departamentit, stafin akademik, studentet, zyrën e sekretarisë mësimore, Karrieres, NJSBC.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga	DI ruan në regjistrat fizikë dhe elektronikë gjithë dokumentacionin vjetor për regjistrimin, ngrirjen e studimeve dhe largimin e studentëve gjatë ciklit të studimit. Ky informacion është i ruajtur në kohë reale në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave nga sekretaria mësimore si dhe në dosjen e secilit student në sekretari, sipas

programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ASCAL-it apo QSHA-së. GVJ takimi në zyrën e sekretarisë mësimore konsaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Numri i studentëve të regjistruar për tri vite akademike në programin Bachelor në “Mami” është si më poshtë: V.a 2022-2023:31 studentë V.a:2023-2024:29 studentë V.a 2024-2025:30 studentë Evidencat: - 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022. - 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023. - 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024. - 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022 - 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023 - 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024 - 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; - 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH. - Takimi me zyrën e sekretarisë mësimore, Karrierës, NJSBC.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore disponon të gjithë dokumentacionin e duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. Ky informacion është në formë fizike me nënshkrimet e personave sipas karakteristikës së dokumentit dhe i ruajtur elektronikisht në sistemin e brendshëm ku secili person i autorizuar ka akses të kufizuar në bazë të pozicionit të punës. Nga takimi me sekretarinë dhe bazuat në rregulloren e

	sekretarisë GVJ konstaton se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit janë të sigurt. Evidencat: - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; - 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional - 1.9; Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale - Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Puna e sekretarisë mësimore është në monitorim të vazhdueshëm nga institucioni në kuadër të hierarkisë dhe mbikqyrjes. Nga auditimi i GVJ u vërejt që në rregjistrat dhe procesverbale ku janë të vendosura notat nuk kishte korigjime. Nga takimi me studentët ata shprehen se janë të kënaqur nga puna e zyrës së sekretarisë mësimore, respektimi i orareve dhe korrektësia e punës nga punonjësit e sekretarisë. GVJ konstaton korrektësi dhe seriozitet në punën e sekretarisë. Evidencat: - 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; - 1.16; Manuali i cilësisë UK; - Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Institucioni përpilon një raport vjetor gjithëpërfshirës të gjitha njësive dhe programeve që ofrojnë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sygjerohen masa për përmirësim. Njësia bazë harton raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Evidencat: - 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022. - 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë

	<i>mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023.</i> - 2.4.3 <i>Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024.</i> - 2.13.1; <i>Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022</i> - 2.13.2; <i>Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023</i> - 2.13.3; <i>Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024</i> - 2.17.1; <i>Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik 2021-2022.</i> - 2.17.2; <i>Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik 2022-2023.</i> - 2.17.3; <i>Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik 2023-2024.</i> - 3.6; <i>Raporti vjetor i NJSBC FSHNH.</i> - 3.7; <i>Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)</i> - <i>Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore, Zyra e Karrierës.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Institucioni garanton të dhëna statistikore të studentëve që menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta. GVJ konstaton korrektësi dhe seriozitet në punën e sekretarisë. Njësia bazë ku realizohet programi i studimit harton raporte analitike, periodike/analiza vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin si dhe punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Nga takimi me studentët dhe stafin akademik si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit nga RVB, GVJ konsaton se studentët përfshihen dhe angazhohen në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Bazuar në rregulloren dhe statutin e UNIKO si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konsaton se studentët janë pjesë e Senatit Akademik, Këshillit Studentorë, Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët, e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm. Evidencat: - 1.1; <i>Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë</i> - 2.2; <i>Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i> - 2.3; <i>Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë";</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se DI përdor sistemin vlerësimit të performancës së stafit akademik, pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave bëhet nga NJSBC dhe përfundon me hartimin e Raportit të Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve, i cili u komunikohet organeve drejtuese, individualisht secilit prej pedagogëve, dhe më pas përgjegjësit të njësisë bazë për të analizuar rezultatet dhe marrjen e masave përkatëse. Gjithashtu departamenti përgjegjës për këtë program studimi mirëpret sygjerrimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe kordinatorit të programit të studimit. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. Nga takimi me studentët dhe stafin akademik si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konsaton se studentët janë pjesë e disa komisioneve në të cilën japin kontributin e tyre (Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,

	Këshilli i Etikës, Këshilli Studentor, Grupit të RVB). Evidencat: - 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - 1.17; Rregullorja e Këshillit studentor - 1.18; Rregullorja për organizimin e zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese; - Takimi me studentët, stafin akademik.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Bazuar në statutin e UNIKO-së zëri dhe përfshirja e studentëve në procese të rëndësishme akademike garantohej me pjesëmarrjen e tyre në organe dhe komisione të rëndësishme si NJSBC, GVB, Senat Akademik etj. Evidencat: - 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional - 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor - 3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët - 3.8.3; Shembull vlerësimi të performancës së stafit akademik - 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion) - Takimi me studentët, stafin akademik.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët kanë të përshkruara të drejtat e tyre në dokumentat rregullatore dhe ato respektohen me rigorozitet nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit me qëllim komentimin e rezultatit dhe kanë të drejtë të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Procedura dokumentohet qartë në RVB. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Departamenti pas procesit të ankimimit ngre komision rivlerësimi të ndryshëm nga komisioni i parë, i cili bën rishqyrtim dhe rivlerësim të

	provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvetësojnë sa më shumë dije. Evidencat: - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë"; - 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; - Takimi me studentët, stafin akademik.			
Konkluzione	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e DI, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UNIKO/DI. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura (NJSBC, GVB), por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB-së. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve dhe problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët, stafin akademik Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Karrierës GVJ konstaton se DI ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve,

përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. (Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës dhe Alumni) Evidencat: - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA - 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ - Takimi me studentët, stafin akademik, Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët, stafin akademik Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Karrierës GVJ konstaton se Sekretaria Mësimore, Zyra e Alumni dhe Karrierës, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë në shërbim dhe në funksion të studentëve. Evidencat: - 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ - Takimi me studentët stafin akademik, Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentet, Zyrën e Karrierës GVJ konstaton se UNIKO/DI, zyra e Karrierës dhe Alumnit, ju ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Evidencat: - 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional - 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ - 4.9; Webfaqja e FSHNH https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencavenatyrore-dhe-shkencave-humane-3/ - 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA - 2.16; Gjurmimi i ecurisë së punësimit (alumni) dhe

	<i>UISH</i> - <i>Takimi me studentet, stafin akademik, Zyra e Karrierës</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët, Zyrën e Karrierës GVJ konstaton se zyra e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Ajo mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data-bazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit. Evidencat: - 1.5; <i>Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional</i> - 4.8; <i>Ëëbfaqja e UK</i> https://unkorce.edu.al/ - 4.9; <i>Ëëbfaqja e FSHNH</i> https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencavenatyrore-dhe-shkencave-humane-3/ - 2.20; <i>Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA</i> - 2.16; <i>Gjurmimi i ecursisë së punësimit (alumni) dhe UISH</i> - <i>Takimi me studentët Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës</i>
Konkluzione	UNIKO/DI ka procedurë dhe njësi të posacme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë struktura të posacme si (Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, Sekretaria mësimore, Drejtoria e Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e IT). Institucioni ka vënë në shërbim të studentëve Zyrën e Këshillimit të Karrierës realizon informimin e studenteve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Zyra e Këshillimit të Karrierës asiston në gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data-bazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit. Këto të dhëna u vihen në dispozicion edhe departamenteve, duke i ndihmuar ata të kenë kontakte të vazhdueshme midis studentëve të diplomuar dhe DI-së dhe Departamentit Mami.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UK nuk ka udhëzues ose manual që nxisin zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies Evidencat: - 1.3; <i>Plani Strategjik i zhvillimit të Universitetit F. S. Noli 2022-2027</i> - <i>Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Në mungesë të një manuali mbi metodat e mësimdhënies nuk ka një mekanizëm të plotë të monitorimit të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Evidencat: - 1.5; <i>Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional</i> - 3.6; <i>Raporti vjetor i NJSBC FSHNH</i> - 3.7; <i>Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)</i> - 3.8.1; <i>Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor</i> - 3.8.2; <i>Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët</i>

	- 3.8.3; Shembull vlerësimi të performancës së stafit akademik - Takimi me stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Burimeve Njerëzore.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Institucioni garanton plotësisht përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. Evidencat: - 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional - 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH - 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion) - 3.10; Lista e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC) - Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Raporti 2023-2024 nuk paraqitet I publikuar në faqen zyrtare të UK sipas evidencave të paraqitura nga NJSBC e UNIKO. Evidencat: - 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional - 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH - 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion) - 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor - 3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët - 3.8.3; Shembull vlerësimi të performancës së stafit akademik - 3.10; Lista e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC)
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për	UK ka udhëzues ose manual që nxisin zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Evidencat: - 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe

përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Vlerësimi Institucional - 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH - 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion) - Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.			
Konkluzione	UK ka udhëzues ose manual që nxisin zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies . Raporti 2023-2024 nuk paraqitet I publikuar në faqen zyrtare të UK sipas evidencave të paraqitura nga NJSBC e UNIKO.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Standartet për sigurimin e cilësisë janë miratuar në përputhje me Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, i miratuar nga ASCAL dhe me udhëzimet europiane për sigurimin e cilësisë HEAL. Manuali i Cilësisë të UK është dokumenti i cili përcakton modalitetet, strukturat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë, në përputhje me kodin e cilësisë. Evidencat: - 1.3; Plani Strategjik i zhvillimit të Universitetit F. S. Noli 2022-2027 - 1.16; Manuali i cilësisë UK; - 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional - Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe	GVJ konsaton se NJSBC e UNIKO ku DI është pjesë e saj, siguron zhvillimin e cilësisë së arsimit dhe ka hartuar një Plan Strategjik të Zhvillimit të UNIKO-së .

zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Evidencat: - 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë - 1.16; Manuali i cilësisë UK; - 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional - Takimi me stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Institucioni ka krijuar mekanizmat e nevojshëm duke përdorur instrumente matëse dhe vlerësuese për vlerësimin periodik të programeve të studimeve dhe i ka përfshirë informacionet e nevojshme në të gjitha vlerësimet e brendshme të cilësisë. Kështu nga shqyrtimi i dokumnetacionit GJV konstatoi se nga Vendimi nr.3, datë 27.01.2023 i Bordit të Akreditimit, ASCAL rezultoi se UNIKO është akredituar pozitivisht deri në 26.01.2027. Evidencat: - 1.16; Manuali i cilësisë UK; - 2.1.1; Çertifikatë dhe vendim akreditimi institucional i UK - Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	UK, nëpërmjet NjSBC, si njësi e posaçme përdor tregues jo të plote dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. Evidencat: - 1.16; Manuali i cilësisë UK; - 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional - Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Konkluzione	Institucioni ka krijuar mekanizmat e nevojshëm duke përdorur instrumente matëse dhe vlerësuese për vlerësimin periodik të programeve të studimeve dhe i ka përfshirë informacionet e nevojshme në të gjitha vlerësimet e brendshme të cilësisë. Kështu nga shqyrtimi i dokumnetacionit GJV konstatoi se nga Vendimi nr.3, date 27.01.2023 i Bordit të Akreditimit, ASCAL rezultoi se UNIKO është akredituar pozitivisht deri në

	26.01.2027. <i>UK, nëpërmjet NJSBC, si njësi e posaçme përdor tregues jo te plote dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe takimi në institucion GJV konstaton se të gjitha gjetjet e vlerësimit vjetor janë pjesë e raportit vjetor të NJSBC, i cili i vihet në dispozicion rektoratit. Këto të dhëna janë bazë për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe vetëvlerësimit. Gjithashtu institucioni kryen një vlerësim të brendshëm vjetor. Ky raport nevojitet të përmiresohet dhe të jetë në nivel programi sepse UNIKO ka disa fusha akademike. Evidencat: - 2.2; <i>Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i> - 2.12.1; <i>Praktika e plotë për miratimin e ndryshimeve të propozuara në kurrikulën e programit</i> - 2.12.2; <i>Procedura e ndryshimeve në planin mësimor (rishikimi i kurrikulës).</i> - 1.5; <i>Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional</i> - <i>Takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e	GJV konstatoi se në raportin vjetor të NJSBC përfshihen rezultatet e pyetësorëve që shoqëruar me grafik për çdo pyetje të drejtuar stafit ose studentëve duke vlerësuar përqindjet e çdo alternative për përgjigjet si dhe duke komentuar rezultatet. Në fund të paraqitjes së rezultateve të pyetësorëve

praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.

bëhet një analizë mbi gjetjet dhe shprehen mundësitë e korigjimit apo përmirësimit dhe rekomandohen plan masash me synim rritjen e cilësisë akademike. Rezultatet e pyetësorëve nevojitet sipas GVJ të jenë në nivel programi më të detajuara dhe më të specifikuar.

Evidencat:

- 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022.
- 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023.
- 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024.
- 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022
- 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023
- 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024
- 2.17.1; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik 2021-2022.
- 2.17.2; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik 2022-2023.
- 2.17.3; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik 2023-2024.
- 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH • 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)
- Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të

Nuk plotësohet në mënyrë të plotë për programin Mami ky kriter.

Evidencat:

- 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022.
- 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023.
- 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024.
- 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-

provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<i>shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022</i> - <i>2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023</i> - <i>2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024</i> - <i>1.16; Manuali i cilësisë UK;</i> - <i>3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)</i> - <i>4.8; Ëebfaqja e UK https://unkorce.edu.al/</i> - <i>4.9; Ëebfaqja e FSHNH https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencavenatyrore-dhe-shkencave-humane-3/</i> - <i>Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Nuk plotësohet në mënyrë të plotë për programin Mami ky kriter. Evidencat: - <i>3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)</i> - <i>3.6; Raporti Vjetor i NJSBC FSHNH</i> - <i>1.16; Manuali i cilësisë UK;</i> - <i>Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Konkluzione	<i>UNIKO përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas herë të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetsorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti. Ky raport nepojitet të përmiresohet dhe të jetë në nivel programi sepse UNIKO ka disa fusha</i>

	<i>akademike.</i> <i>Rezultatet e pyetësorëve nevojitet sipas GVJ të jenë në nivel programi më të detajuara dhe më të specifikuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Aktorët të cilët përfshihen në sigurimin e cilësisë të institucionit pëcaktohen në Manualin e cilësisë së UK, si dhe janë të specifikuar detyrat, përgjegjësitë dhe roli i tyre në kuadër të sigurimit të cilësisë. Ajo çka nuk evidentohet është prezenca e raporteve analitike në lidhje me këtë program. Evidencat: - 1.16; Manuali i cilësisë UK; - 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH. - 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional - Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Deklarohet që arrijtet dhe problematikat e hasura, raportohen dhe diskutohen në mbledhje të hapura të departamentit dhe fakultetit, me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative (nuk ka evidencë për këtë). Evidencat: - 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022. - 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023. - 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë

	<i>mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024.</i> - <i>1.3; Plani Strategjik i zhvillimit të Universitetit F. S. Noli 2022- 2027</i> - <i>2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022</i> - <i>2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023</i> - <i>2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024</i> - <i>2.17.1; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik 2021-2022.</i> - <i>2.17.2; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik 2022-2023.</i> - <i>2.17.3; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik 2023-2024.</i> - <i>Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë. Evidencat: - <i>3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor</i> - <i>3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët</i> - <i>3.8.3; Shembull vlerësimi të performancës së stafit akademik</i> - <i>3.10; Lista e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC)</i> - <i>Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin	GVJ konstatoi se lidhur me përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit,

akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	pyetësori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmangët çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studenteve. Evidencat: - 1.19; Rregullore e Këshillit të Etikës UK - Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Deklarohet që pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, për programin e studimit "Mami" janë edhe studentët e diplomuar (Alumni) dhe punëdhënësit (nuk ka raport analitik në lidhje me kete). Evidencat: - 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale; - 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale. - 3.11; Studim tregu për programin e studimit - 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ - Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.			
Konkluzione	NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjithë UNIKO/DI.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika,	Deklarohet që çdo vit ka një raport vjetor ku studentët dhe të


strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.

gjitha palët e interesuara rreth SBC për programin e studimit, kanë akses të plotë informimi në faqen Web të Universitetit (nuk evidentohet në faqen web).

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE
Nuk kemi të dhëna për këtë fakultet pasi nuk është dorësuar RVB e fakultetit

Sektorit i Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni
Evis Kapurani

Raport i Vlerësimit të Brendshëm Fakulteti i



Komisioni i sigurimit të cilësisë, programeve të studimit e kërkimit shkencor - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

Evidencat:

- 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë
- 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë
- 1.3; Plani Strategjik i zhvillimit të Universitetit F. S. Noli 2022- 2027.
- 1.16; Manuali i cilësisë UK;
- 4.8; Webfaqja e UK <https://unkorce.edu.al/>
- Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.

Deklarohet që NJSBC harton në mënyrë periodike raporte të vlerësimit të brendshëm, të cilat si fillim i përcillen Rektoratit dhe Senatit Akademik e më pas ruhen në arkivën e FSHNH dhe UK dhe janë të publikuara në faqen web të UK (nuk evidentohet kjo).

Evidencat:

- 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë
- 1.9; Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale
- Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nuk ka raport analitik për këtë kriter në nivel program dhe department, por ka disa rregullore që adresojnë përmirësimin e mangësive dhe përmirësimeve në nivel universiteti. Evidencat: - 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë - 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH - 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë"; - Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nuk ka raport vjetor për këtë kriter në nivel programi. Evidencat: - 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022. - 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023. - 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024. - 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH - Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se institucioni organizon veprimtari periodike me personelin akademik dhe studentët me qëllim informimin, asistencën dhe trajnimin për një pjesëmarrje aktive dhe efektive në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke i informuar dhe ndërgjegjësuar për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Evidencat: - 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH - 1.17; Rregullorja e Këshillit Studentor - 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor - Takimi me studentët, përgjegjësin e departamentit, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.

Konkluzione	<i>GVJ rekomandon përfshirjen në rregullore të NJSBC edhe të aktoreve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Mami" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Fan S . Noli" Korçë.

Pika të forta dhe afirmime:

1. Numri i stafit akademik në vite është i qëndrueshëm dhe i gjithë personeli akademik i UNIKO/DI kanë grada akademike dhe disa janë në proces.
2. Stafi mbikqyrës i praktikës profesionale i raportuar nga Institucioni, bazuar dhe në Statutin e UNIKO, janë staf i spitalit të Korçës dhe kjo është një pikë e fortë për këtë program studimi.
3. Pjesa më e madhe e studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi janë të punësuar.
4. Nga takimi me studentët dhe stafin akademik u evidentua se një pjesë e vetë stafit akademik shërben si treg pune, duke punësuar ish studentët e tyre apo i kanë referuar tek kolegët e tyre për punësim në klinikat private.
5. GVJ evidenton që ka një evidencë mbi numrin e studentëve për çdo grup praktike dhe cilat praktika udhëheqin çdo specialist në kurset përkatëse sipas Vendimit Nr.41 datë 24.01.2018 për ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË.

Pika të dobëta:

1. Plan i mësimor nuk është i përafuar me Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 28.12.2023. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar .Ky vendim është pasqyrim i direktivave europiane të profesioneve. (Standard III)
2. Mungesa e njësisë kryesore në fushën e shëndetësisë sipas VKM nr 41. (Standardi I.1, Kriteri 5)
3. Mungesa e stafit PAE me titull "Profesor", vështirëson dhe krijon mangësi në përmbushjen e një detyrimi të nevojshëm të diskutimit dhe miratimit të programeve lëndore (Syllabuseve) nga titullari i lëndës, i fushës përkatëse, me titullin dhe gradën e kërkuar në ligj. (Standardi II.2, Kriteri 1)
4. Biblioteka e FSHNH, e cila për arsye objektive të përkohëshme është në proces ristrukturimi, krijon një boshllëk në shfrytëzimin e librit fizik dhe mjediseve për studim, edhe pse kompensohet nga biblioteka qendrore. (Standardi IV.3, Kriteri 3)

Rekomandime:

1. Standardi II.1: Për kriterin 6, GVJ nuk evidentoi një evidencë të tillë gjatë takimeve me stafet e UNIKO-së, por dhe evidencave të paraqitura.
2. Standardi II.2: Kriteri 1 duhet të përmirësohet sepse nuk është në fushën akademike të njësive kryesore, duke rekomanduar togfjalëshin “Shkencave të shëndetit ose mjeksore”. Ndërsa njësia bazë përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.
3. Standardi II.2: GVJ rekomandon punësimin e së paku një laboranti në fushën përkatëse në mënyrë që të përmbushet kriteri 2.
4. Standardi II.2: GVJ rekomandon që koordinatori i programit të jetë me një nga ciklet e diplomimit Mami.
5. Standardi II.3: GVJ evidenton që ka predispozitë nga ana e stafeve që të shtojnë orët e praktikave, por VKM nr 41 i ka kufizuar për shkak të nenit 2.1. të VENDIM Nr. 41, datë:24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË.
6. Standardi II.3: GVJ evidenton që nuk ka një procedurë të përmirësimit të syllabuseve dhe rekomandon që të përfshihet NJSBC në këtë proces, ose të ndahet DI në grupe mesimore/shkencore.
7. Standardi II.4: GVJ evidenton që programi duhet të përafrohet me “ VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023: PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR” .
8. Standardi II.4: GVJ evidenton që programi i përmbahet pjesërisht kompetencave të Mami-së sepse VKM nr 823 dhe direktivat europiane e kanë të përshkruar ndryshe dhe prandaj duhen përmirësuar
9. Standardi II.4: GVJ nuk evidenton një studim tregu për programin “Mami”. Prandaj rekomandohet një i tillë.
10. Standardi II.5: Për kriterin 1, GVJ evidenton që nuk ka evidencë të tillë që është përshtatur apo riorganizuar. Për kriterin 3 ka marrëveshje me aktorë të ndryshëm, por nevojitet që të ketë raporte analitike në lidhje me vijueshmërinë dhe përmirësimin e programit. Standardi II.1: GVJ rekomandon që të grupohen lëndët dhe modulet.
11. Standardi III.1: Në kuadër të plotësimit të kriterit 2 GVJ rekomandon të pasqyrohen në syllabus format mesimore si psh raste klinike apo forma të tjera. GVJ evidenton se nuk ka trajnime apo manuale të mësimdhënies që ndihmojnë pedagogun dhe studentin në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rekomandohet që në vitin e ri akademik të ri të miratohet në senat.
12. Standardi III.4: GVJ evidenton që programi duhet të përafrohet me “ VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023: PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR”. Në kriterin 5 GVJ evidenton që përveç

aktiviteteve në kuadër të sensibilizimit të diabetit apo autizmit, nuk paraqitet një evidencë që të plotësohet ky kriter.

13. Standardi VI.1: UNIKO nuk ka udhëzues ose manual që nxisin zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Nuk ka evidencë të publikimit të raportit të studenteve në lidhjen me mësimdhënie.

Conclusions of the evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "Midwifery" offered offered by the "Fan S. Noli" University, Korça

Strengths and Affirmations:

1. The number of academic staff over the years is stable and all academic staff of UNIKO/DI have academic degrees and some are in the process.
2. The supervisory staff of professional practice reported by the Institution, based on the UNIKO Statute, are staff of the Korca hospital and this is a strong point for this study program.
3. The vast majority of students who have completed this study program are employed.
4. From the meeting with students and academic staff, it was evident that part of the academic staff itself serves as a job market, by employing their former students or referring them to their colleagues for employment in private clinics.
5. GVJ certifies that it has evidence on the number of students for each practice group and which practices each specialist leads in the relevant courses according to Decision No. 41 dated 24.01.2018 on ELEMENTS OF STUDY PROGRAMS OFFERED BY HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS.

Weaknesses:

1. The curriculum is not aligned with the Decision of the Council of Ministers No. 823, dated 28.12.2023. On some additions and changes to the Decision No. 41, dated 24.1.2018, of the Council of Ministers, "On the elements of study programs offered by higher education institutions", as amended. This decision is a reflection of the European directives on professions. . (Standard III).
2. Lack of the main unit in the field of health according to VKM No. 41. (Standard I.I, Criterion 5)
3. The lack of PAE staff with the title of "Professor" makes it difficult and creates shortcomings in fulfilling a necessary obligation of discussing and approving subject

programs (Syllabuses) by the head of the subject, of the relevant field, with the title and rank required by law. (Standard II.2, Criterion 1)

4.The FSNH library, which for temporary objective reasons is in the process of restructuring, creates a gap in the use of physical books and study facilities, although it is compensated by the central library. (Standard IV.3, Criterion.3)

Recommendations:

1. Standard II.2: Criterion 1 should be improved because it is not in the academic field of the main unit, recommending the phrase "Health or medical sciences". While the basic unit meets the obligations set out in the legislation in force for the organization and academic structure, academic staff, evaluation and accreditation.
2. Standard II.2: GVJ recommends the employment of at least one laboratory technician in the relevant field in order to meet criterion 2.
3. Standard II.2: GVJ recommends that the program coordinator be with one of the graduation cycles in Midwifery.
4. Standard II.3: GVJ highlights that there is a predisposition on the part of the staff to increase the hours of internships, but VKM no. 41 has limited them due to article 2.1. of DECISION No. 41, dated:24.1.2018 ON ELEMENTS OF STUDY PROGRAMS OFFERED BY HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS.
5. Standard II.3: GVJ highlights that there is no procedure for improving syllabuses and recommends that the NJSBC be included in this process, or that DI be divided into teaching/scientific groups.
6. Standard II.4: GVJ highlights that the program should be aligned with " DECISION No. 823, dated 28.12.2023: ON SOME ADDITIONS AND AMENDMENTS TO DECISION NO. 41, DATED 24.1.2018, OF THE COUNCIL OF MINISTERS, "ON ELEMENTS OF STUDY PROGRAMS OFFERED BY HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS", AMENDED" .
7. Standard II.4: GVJ evidences that the program partially complies with the competencies of the Midwife because the VKM no. 823 and the European directives have it described differently and therefore needs to be improved
8. Standard II.4: GVJ does not evidence a market study for the "Midwife" program. Therefore, one is recommended.
9. Standard II.5: For criterion 1, GVJ evidences that there is no evidence that it has been adapted or reorganized. For criterion 3, there are agreements with various stakeholders, but there is a need for analytical reports regarding the continuity and improvement of the program.
10. Standard II.1: GVJ recommends that subjects and modules be grouped.
11. Standard III.1: In the context of fulfilling criterion 2, GVJ recommends that teaching formats such as clinical cases or other forms be reflected in the syllabus. GVJ highlights that there are no training or teaching manuals that help the teacher and the

student in the teaching and learning process. It is recommended that it be approved by the Senate in the new academic year.

12. Standard III.4: GVJ highlights that the program should be aligned with “ DECISION No. 823, dated 28.12.2023: ON SOME ADDITIONS AND AMENDMENTS TO DECISION No. 41, DATED 24.1.2018, OF THE COUNCIL OF MINISTERS, “ON ELEMENTS OF STUDY PROGRAMS OFFERED BY HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS”, AMENDED”. In criterion 5 GVJ highlights that apart from activities within the framework of diabetes or autism awareness, there is no evidence to meet this criterion.
13. Standard VI.1: UNIKO does not have guidelines or manuals that encourage the development and use of diverse and innovative teaching methods. There is no evidence of the publication of student reports related to teaching.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X